



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Programi qeverisës 2020–2023

Maj 2020

Përmbajtja

1. PARIMET DHE OBJEKTIVAT QEVERISËSE.....	4
2. MENAXHIMI I PANDEMISË NGA COVID-19.....	5
2.1. Menaxhimi i pandemisë gjatë fazës emergjente	5
2.2. Masat monitoruese dhe reaguese për periudha afatgjata	6
3. RIMËKËMBJA EKONOMIKE PAS PANDEMISË	9
3.1. Masat e menjëhershme për parandalim të daljes së bizneseve nga tregu.....	9
3.2. Masat për rimëkëmbje për 2020 dhe 2021.....	9
4. QEVERISJA, REFORMA INSTITUCIONALE DHE KOHEZIONI SHOQËROR	15
4.1. Qasja ndaj reformës institucionale të administratës publike	15
4.2. Bashkëpunimi me pushtetit lokal.....	15
4.3. Partneriteti me shoqërinë civile dhe mediet.....	15
4.4. Luftimi i korrupsionit dhe i krimit të organizuar	16
4.5. Përmirësimi i procesit zgjedhor.....	16
4.6. Promovimi i barazisë shoqërore.....	16
4.7. Të pagjeturit dhe viktimat e dhunës seksuale nga lufta.....	16
4.8. Fuqizimi i pozitës së femrave në shoqëri	17
5. ZHVILLIMI EKONOMIK GJITHËPËRFSHIRËS DHE I QËNDRUESHËM.....	18
5.1. Sektorit privat.....	18
5.2. Politikat tatimore.....	19
5.3. Shpenzimet publike dhe madhësia e sektorit publik	19
5.4. Zvogëlimi i ekonomisë joformale	20
5.5. Mbështetja e biznesit për të zvogëluar kostot e prodhimit dhe të funksionimit	20
5.6. Eliminimi i barrierave ligjore dhe zvogëlimi i burokracisë.....	20
5.7. Ndërmarrjet publike dhe privatizimi	21
5.8. Sistemi financiar	22
5.9. Investimet e jashtme	22
5.10. Turizmi	22
5.11. Fondi Zhvillimor-Investiv	23
5.12. Anëtarësimi në organizatat ekonomike ndërkombëtare	23
5.13. Teknologjia informative.....	23
6. DREJTËSI E PAVARUR DHE EFIKASE.....	24
6.1. Avancimi dhe forcimi i institucioneve të drejtësisë.....	24
6.2. Llogaridhënia dhe efikasiteti i sistemit të drejtësisë	24
6.3. Legjislacioni dhe zbatueshmëria	24
6.4. Luftimi i korrupsionit, krimeve dhe terrorizimit.....	25
7. POLITIKA E JASHTME, INTEGRIMI NË BE DHE DIALOGU ME SERBINË	26
7.1. Politika e jashtme	26
7.1.1. Prioritetet politike.....	26
7.1.2. Prioritetet funksionale	28
7.2. Integrimi në BE	29
7.3. Dialogu me Serbinë	30
8. ARSIMI DHE SHKENCA.....	Error! Bookmark not defined.
8.1. Pandemia nga COVID-19 dhe përmbyllja e vitit shkollor 2019-2020.....	Error! Bookmark not defined.
8.2. Avancimi i strukturave dhe funksioneve në arsim	Error! Bookmark not defined.
8.3. Infrastruktura arsimore	Error! Bookmark not defined.
8.4. Kurrikula arsimore	Error! Bookmark not defined.

8.5.	Edukimi parashkollor	Error! Bookmark not defined.
8.6.	Arsimi parauniversitar	Error! Bookmark not defined.
8.7.	Arsimi profesional.....	Error! Bookmark not defined.
8.8.	Arsimi i lartë	Error! Bookmark not defined.
8.9.	Gjithëpërfshirja dhe barazia në arsim	Error! Bookmark not defined.
8.10.	Arsimi për komunitetet jo shumicë	Error! Bookmark not defined.
8.11.	Shkenca.....	Error! Bookmark not defined.
8.12.	Koordinimi i donatorëve.....	Error! Bookmark not defined.
9.	SHËNDETËSIA	Error! Bookmark not defined.
9.1.	Prioritetet në shëndetësi dhe reformat kryesore	Error! Bookmark not defined.
9.2.	Roli i Ministrisë së Shëndetësisë	Error! Bookmark not defined.
9.3.	Financimi i shëndetësisë.....	Error! Bookmark not defined.
9.4.	Menaxhimi dhe llogaridhënia.....	Error! Bookmark not defined.
9.5.	Shëndeti publik dhe parandalimi i sëmundjeve ngjitëse	Error! Bookmark not defined.
9.6.	Edukimi dhe shkollimi specialistik dhe subspecialistik....	Error! Bookmark not defined.
9.7.	Edukimi publik shëndetësor	Error! Bookmark not defined.
9.8.	Sektori farmaceutik	Error! Bookmark not defined.
9.9.	Licencimi dhe Akreditimi i institucioneve shëndetësore.	Error! Bookmark not defined.
9.10.	Zhvillimi i partneritetit dhe dialogu social	Error! Bookmark not defined.
9.11.	Sektori privat shëndetësor	Error! Bookmark not defined.
9.12.	Përgjegjësitë dhe integrimi i tri niveleve të kujdesit shëndetësor .	Error! Bookmark not defined.
	defined.	
9.13.	Bashkëpunimi ndërkombëtar	Error! Bookmark not defined.
10.	BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL.....	Error! Bookmark not defined.
10.1.	Rritja e investimeve në fermë dhe në sektorët prioritarë	Error! Bookmark not defined.
10.2.	Siguria e ushqimit	Error! Bookmark not defined.
10.3.	Ujitja e tokave bujqësore	Error! Bookmark not defined.
10.4.	Funksionalizimi i sigurimeve bujqësore.....	Error! Bookmark not defined.
10.5.	Lehtësimi i qasjes në financa për fermerë	Error! Bookmark not defined.
10.6.	Zinxhiri i vlerës në prodhimin bujqësorë	Error! Bookmark not defined.
10.7.	Përkrahja e aktiviteteve jo bujqësore dhe diversifikimi i zhvillimit rural	Error! Bookmark not defined.
	defined.	
10.8.	Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore	Error! Bookmark not defined.
10.9.	Mbrojtja dhe valorizimi i resurseve pyjore.....	Error! Bookmark not defined.
11.	INFRASTRUKTURA, ENERGJIA, MINIERAT, UJËRAT DHE AMBIENTI	Error! Bookmark not defined.
	not defined.	
11.1.	Infrastruktura rrugore dhe hekurudhore	Error! Bookmark not defined.
11.2.	Energjia	Error! Bookmark not defined.
11.3.	Minierat	Error! Bookmark not defined.
11.4.	Resurset ujore.....	Error! Bookmark not defined.
11.5.	Ambienti	Error! Bookmark not defined.
12.	MBROJTJA DHE SIGURIA PUBLIKE.....	Error! Bookmark not defined.
12.1.	Forca e Sigurisë së Kosovës	Error! Bookmark not defined.
12.2.	Forcat e rendit dhe të sigurisë publike.....	Error! Bookmark not defined.
13.	MBROJTJA SOCIALE DHE INTEGRIMI NË PUNËSIM.	Error! Bookmark not defined.
13.1.	Mbrojtja sociale.....	Error! Bookmark not defined.
13.2.	Integrimi në punësim.....	Error! Bookmark not defined.
14.	KULTURA, RINIA DHE SPORTI.....	Error! Bookmark not defined.
14.1.	Kultura	Error! Bookmark not defined.

14.2. Rinia	Error! Bookmark not defined.
14.3. Sporti	Error! Bookmark not defined.
15. DIASPORA.....	Error! Bookmark not defined.

1. PARIMET DHE OBJEKTIVAT QEVERISËSE

Qeveria e Republikës së Kosovës do të jetë mbrojtëse dhe zbatuese e të gjitha parimeve dhe normave që burojnë nga Kushtetuta e Kosovës, pa dallim. Ruajtja e pavarësisë, sovranitetit, integritetit territorial dhe rendit kushtetues të Kosovës, për Qeverinë e Republikës së Kosovës është detyrim shtetëror thelbësor që buron nga vullneti i qytetarëve të Kosovës. Përparimi i lirive qytetare, mbrojtja e pronës private, promovimi i mundësive të barabarta, forcimi i ekonomisë së tregut, promovimi i drejtësisë efikase dhe asnjëse, do jenë postulatet kryesore që do të karakterizojnë ndërgjegjen politike të Qeverisë. Do të promovohet përcaktimi strategjik i Republikës së Kosovës për forcimin e stabilitet në rajon, duke krijuar marrëdhënie të fqinjësisë së mirë me të gjitha shtetet në rajon. Integrimi i vendit në Bashkimin Evropian dhe NATO do të jetë qëllim nga i cili burojnë angazhimet institucionale për përparimin e demokracisë, ekonomisë dhe shtetit të së drejtës.

Qeveria e Republikës së Kosovës synon të vendosë dhe të fuqizojë një qeverisje kompetente dhe të përgjegjshme, e cila do të forcojë besimin e qytetarëve të Kosovës dhe të partnerëve tanë strategjik, BE dhe SHBA, në vitalitetin e Kosovës si shtet i pavarur, duke zbatuar politika që e rrisin cilësinë e jetës, që respektojnë të drejtat e secilit dhe ofrojnë mundësi të barabarta në arsim, shëndetësi, në jetën sociale dhe në shërbimet publike në përgjithësi.

Programi qeverisës, i ndërtuar mbi prioritetet nacionale të Kosovës, bazohet në vlerat demokratike, si: respekti për traditën, drejtësia, toleranca, përgjegjësia dhe transparencja, liria individuale dhe kolektive. Këto vlera paraqesin bazamentin e shoqërisë moderne evropiane të Kosovës. Si i tillë, programi qeverisës ofron mundësi për realizimin e vizionit për Kosovën shtet i pavarur dhe demokratik, i zhvilluar dhe i integruar në strukturat euroatlantike, me funksionim të pavarur të pushteteve. Sot, Kosova po ballafaqohet me një situatë të rëndë, si rezultat i pandemisë nga COVID-19, si në aspektin e shëndetit publik ashtu edhe në aspektin ekonomik. Prandaj, objektivat themelore të Qeverisë janë:

- (i) beteja për ta mposhtur pandeminë dhe
- (ii) rimëkëmbja e ekonomisë pas pandemisë.

Krahas këtyre objektivave, Qeveria ka prioritet:

- (i) Forcimin e shtetit, avancimin e demokracisë, luftimin e dukurive negative, veçmas krimin dhe korrupsionit;
- (ii) Zhvillimin ekonomik bazuar në ekonominë e tregut, rritjen e punësimit dhe investimeve, për t'u përballur me pasojat e pandemisë dhe nevojën për fuqizim të aftësisë konkurruese të bizneseve dhe prodhimeve vendore;
- (iii) Marrjen e përgjegjësive për të çuar përpara dialogun me Serbinë, në bashkëpunim me BE dhe SHBA, duke mos lejuar ndryshim të kufijve dhe shkëmbim të territorit;
- (iv) Avancimin e procesit të integritimit evropian, përmes zbatimit të MSA-së, si dhe procesit të integritimeve euroatlantike;
- (v) Zbatimin e plotë të Agjendës së Reformave Evropiane;

- (vi) Krijimin e klimës së bashkëpunimit pozitive-opozitive për çështjet vitale në interes të vendit dhe vendimmarrje në konsultim të gjerë dhe gjithëpërfshirës, sidomos në procesin e dialogut me Serbinë.

2. MENAXHIMI I PANDEMISË NGA COVID-19

Natyra evolutive dhe shpejtësia e zhvillimit të pandemisë COVID-19, e përcjellë me të panjohura në zhvillimin e sëmundjes që shkakton, kanë çuar në sfida të pashembullta për sistemet e kujdesit shëndetësor, si dhe në ndikime dramatike socio-ekonomike në gjithë botën. Kriza tashmë ka marrë mijëra jetë dhe vazhdon të vë sistemet e kujdesit shëndetësor nën një tendosje të madhe. Të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian ndaluan mbledhjet publike, shkollat u mbyllën dhe u vendosën kufizime udhëtimi. Më shumë se gjysma e shteteve anëtare të BE-së shpallën gjendje të jashtëzakonshme. Këto masa kufizuese u panë të nevojshme për të ngadalësuar përhapjen e virusit dhe kanë shpëtuar tashmë jetë njerëzish edhe te ne.

2.1. Menaxhimi i pandemisë gjatë fazës emergjente

Kjo epidemi, si edhe epidemitë e tjera, do të arrijë kulmin, si në aspektin e numrit të rasteve të reja, ashtu edhe të numrit të vdekjeve në ditë, dhe pastaj do të bjerë brenda disa javësh. Kur do të ndodhë ngadalësimi, shprehur përmes uljes së numrit të infeksioneve të reja dhe vdekjeve, do të zbatohet një strategji shëndetësore për përballje në periudha më të gjata me këtë pandemi. Kjo për shkak se strategjia afat-shkurtër, e bazuar mbi të gjitha në masat e izolimit dhe distancimit shoqëror të popullatës, nuk duket të jetë e qëndrueshme për më shumë se disa javë.

Për këto arsye, do të zhvillohen masat për dalje graduale nga izolimi shoqëror, të cilat do të vihen në zbatim pas një periudhe të arsyeshme kohore të rënies së numrit të infektiveve të reja. Duke marrë parasysh edhe zhvillimet ndërkombëtare në këtë aspekt, ajo që kërkohet është kalimi nga faza "pandemike" e COVID-19 në atë "endemike".

Në bazë të rekomandimeve të Qendrës Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC), Panelit Këshillëdhënës i Komisionit Evropian dhe rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), Komisioni Evropian ka publikuar një Udhëzues (Roadmap) me direktiva se kah duhet lëvizur në fazën e re të ballafaqimit me COVID-19. Ky udhëzues do na shërbejë edhe ne që të koordinojmë veprimet tona me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik.

Nga pikëpamja shkencore, ekzistojnë të paktën tre faktorë kryesorë që mund të kontribuojnë në skenarin që parashihet një fund të afërt për fazën "akute" të epidemisë. Natyrisht se faktori i parë është izolimi individual dhe distanca sociale (përveç masave individuale të higjienës). Faktori i dytë, që megjithatë duhet të vlerësohet, është shtrirja e imunitetit natyror ndaj COVID-19 në një pjesë të rëndësishme të popullatës. Faktori i tretë, që gjithashtu duhet të konfirmohet, por me sa duket jo më pak i rëndësishëm, është sezonaliteti (stinët me shumë diell) që vlen për viruset e tjerë të frymëmarrjes, përfshirë koronavirusët, të cilët preferojnë sezonin e dimrit për tu shtuar dhe shpërndarë, e jo pranverën e vonë apo verën e vjeshtë e hershme.

Meqenëse asnjë vaksinë kundër këtij virusi nuk është në dispozicion, mënyra e vetme për të vlerësuar se si kanë vepruar këta faktorë në zvogëlimin e numrit të infeksioneve (dhe vdekshmërisë që pason) është të marrim mostra testuese në masë të madhe, në mënyrë që popullsia e përgjithshme, në zonat e ndryshme gjeografike të vendit, të vlerësohet për

gjendjen e infeksionit aktiv. Ky testim duhet të bëhet edhe për konstatimin e gjendjes së imunitetit të popullatës, përmes analizave serologjike për praninë e antitropave specifike. Nëse vlerësohet se niveli i imunitetit specifik në popullatë është i ulët, atëherë e vetmja strategji për të "rihapur" Kosovën do të jetë monitorimi në intervale të rregullta i kthimit të mundshëm të virusit, në mënyrë që të "lëvizim shpejtë dhe në faza të hershme të përhapjes së virusit". Ky plan veprimi do të mundësojë rivendosjen e shpejtë të masave të izolimit individual dhe distancimit shoqëror, kur ekziston rreziku i fortë i shpërthimit të epidemisë. Nëse, nga ana tjetër, imuniteti i fituar spontanisht si rezultat i kësaj epidemie rezulton të jetë mjaft i lartë, monitorimi duhet të përqendrohet në vlerësimin e karakteristikave të përgjithshme të këtij imuniteti me kalimin e kohës, duke parashikuar përfshirjen e monitorimit virologjik me anë të tamponeve diagnostikuese të synuara, veçanërisht nëse prania e një përgjigjeje imune specifike jep shenja të dobësimit ose të joefektivitetit. Kjo pandemi sigurisht se do të ketë ndikim në marrëdhënie tona me vendet e tjera dhe lëvizjen e qytetarëve dhe mallrave. Në këtë drejtim, rol të rëndësishëm do të luajë shërbimi jonë diplomatik në riatdhesimin e qytetarëve për aq sa zgjasin masat e pandemisë, por edhe më vonë për shkak të standardeve që mund të vendosen në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve. Prandaj, do të punohet me ambasadat residente në Kosovë dhe me misionet tona nëpër botë për të koordinuar këtë proces dhe për të ofruar çfarëdo ndihme që mund të jetë e nevojshme. Për qytetarët tanë jashtë vendit, që gjatë kohës së pandemisë vendosin të qëndrojnë aty ku janë, misionet tona diplomatike do të ofrojnë shërbimet e tyre gjatë gjithë kohës së pandemisë, përmes shërbimeve të avancuara digjitale. Misionet tona diplomatike dhe Ministria e Jashtme do të angazhohen për të koordinuar edhe mbështetjen që mund të kemi nga partnerët tanë në përballimin e pandemisë.

2.2. Masat monitoruese dhe reaguese për periudha afatgjata

Për t'u rikthyer gradualisht në jetën tonë të zakonshme, duhet të krijohet një infrastrukturë mobile monitorimi dhe reagimi ndaj COVID-19 dhe, ndoshta në të ardhmen, të epidemive të tjera. Në këtë drejtim, do të krijohen kapacitetet institucionale, profesionale dhe shkencore, publike dhe private, në mënyrë që analizohet vazhdimisht situata, të këshillohen institucionet respektive dhe të udhëzohen për mobilizim kurdo që shihet e nevojshme. Kjo infrastrukturë duhet të jetë e unifikuar në aspektin profesional nga lëmi të ndryshme shkencore dhe të jetë në mbështetje të vendimmarrjes nga institucionet respektive shtetërore.

Kjo infrastrukturë duhet të ketë këto karakteristikat të përgjithshme:

- (i) Të ketë kapacitete për të kryer numër shumë të madh testesh, si virologjike, ashtu edhe serologjike, në popullatën e përgjithshme simptomatike, me procedura të shpejta të autorizuara nga institucionet kompetente të nivelit qendror, të cilat aktivizohen në rast të sinjalit se epidemia mund të shpërthejë. Për këtë qëllim, duhet të bëhet decentralizim i kapaciteteve testuese në spitale rajonale, në kujdesin parësor dhe në institucione private shëndetësore, të cilat lehtë dhe shpejt ofrojnë testimet për të gjitha grupet e rrezikut, për personat që kujdesën për pacientë kronik, por edhe për personat asimptomatikë ose ata që janë në kontakt të afërt me rastet e konfirmuara. Kjo shtrirje e testimit duhet të përfshijë edhe testimet serologjike.

Duhet të merret në konsideratë edhe përcaktimi i pikave të vetëtestimit publik, me të cilat do të ulej presioni ndaj sistemit shëndetësor;

- (ii) Të krijohet një strukturë qendrore e mbikëqyrjes, përgjegjëse për analizën e të dhënave në kohën "gati-reale" dhe prezantimin e tyre Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrisë së Shëndetësisë, në baza të rregullta, dhe pastaj nga Qeveria te Parlamenti, organizatat shëndetësore ndërkombëtare dhe publiku;
- (iii) Të forcohen kapacitetet rajonale të mbikëqyrjes epidemiologjike, në formën e qendrave të monitorimit periferik, me shpërndarje në të gjithë territorin dhe me zhvillimin e sistemeve "të inteligjencës epidemike" që zbulojnë herët çdo shenjë të fillimit të shpërthimeve të epidemive. Në këtë drejtim duhet konsideruar zbatimin e aplikacioneve celulare që paralajmërojnë qytetarët për një rrezik të rritur për shkak të kontaktit me një person pozitiv me COVID-19, masë kjo e këshilluar nga udhëzuesi i Komisionit Evropian;
- (iv) Do të forcohet rrjetëzimi midis strukturave operative dhe profesionistëve që përbëjnë linjën e parë të takimit dhe të mbrojtjes drejtpërdrejt nga COVID-19, që nga faza simptomatike, duke promovuar integrimin e rrjetit të institucioneve shëndetësore që merren me sëmundje infektive në të gjithë territorin e vendit, me atë të mjekësisë primare dhe sekondare;
- (v) Do të sigurohet mandati ligjor për të propozuar dhe ndërmarrë masa fleksibile në kohën e duhur në përgjigje të shenjave të kthimit të virusit, duke përfshirë format e izolimit shoqëror (siç është pezullimi i aktiviteteve, ngjarjet sportive, shkollave, etj.), menaxhimi i të infektuarve dhe kontakteve (duke zbatuar edhe teknologjitë e përshtatshme si aplikacionet telefonike të testuar tashmë në disa vende), dhe forcimin e strukturave specifike të kujdesit shëndetësor;
- (vi) Do të ndërtohet një strategji e komunikimit, së bashku me mediet, për të shmangur dëmet e mundshme nga alarmimi i ekzagjuar, por edhe nga nënvlerësimi i rrezikut, duke përdorur, po ashtu, përvoja në marrëdhëniet mjek-pacient.

Një projekt i tillë ambicioz i monitorimit dhe reagimi ndaj rrezikut të kthimit të infeksionit nga COVID-19, i bazuar në të dhëna dhe analiza në kohë reale, paraqet një investim të konsiderueshëm të burimeve (personeli, infrastruktura, testet, analizat, etj.) për zbatimin e shpejtë të tij në katër deri në gjashtë muaj.

Një projekt i tillë kërkon edhe përcaktim të hollësishëm të kornizës ligjore dhe rregullative, brenda të cilës kjo strukturë do të funksionojë në harmoni dhe në sinergji me subjektet përkatëse politike, administrative, shëndetësore dhe tekniko-shkencore, në të dy nivelet, kombëtar dhe lokal.

Forcimi i sistemit të monitorimit dhe të reagimit në nivelin të shëndetit publik, duhet të shoqërohet me një plan të përgjithshëm për të kufizuar rrezikun e shpërthimit të epidemisë në vendin e punës dhe në institucione arsimore. Prandaj, duhet të parashikohet një ristrukturim i thellë i procedurave dhe aktiviteteve për ambiente pune në ndërmarrje ku ka

grumbullim të madh të punëtorëve, si dhe në institucione arsimore për të kufizuar përhapjen e viruseve të frymëmarrjes.

Vetëm një qasje e tillë e menaxhimit të situatës, ku fillimisht vendoset kontrolli dhe kufizohet përfundimisht përhapja e virusit dhe pastaj vendosen masat për identifikim të hershëm të rikthimit të virusit, mundëson kthim në normalitet. Në këtë drejtim, qenësore mbetet rritja e kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së sistemit tonë shëndetësor. Prandaj, është e domosdoshme të bëhen investime imediate në rritjen e kapaciteteve spitalore, mjeteve të punës dhe trajnimin e stafit mjekësor.

3. RIMËKËMBJA EKONOMIKE PAS PANDEMISË

Qeveria e re do të ketë program të veçantë për rimëkëmbje ekonomike, pasi, përveç ndikimit në shëndetin publik dhe në jetën e qytetarëve, COVID-19 do të shkaktojë një shok ekonomik, duke ndikuar negativisht në prodhim, punësim, të ardhura dhe eksporte, dhe kjo vetëm si një valë e parë. Ndikimin e plotë do ta ndiejmë në pjesën e dytë të vitit 2020, kur të shfaqen efektet multiplikuese, përmes rënies së investimeve dhe remitencave.

Masat për rimëkëmbje ekonomike do të bazohen në një analizë të përgjithshme të ndikimit ekonomik të COVID-19. Këto masa do të përmblihdh në kuadër të “Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike pas Pandemisë COVID-19”, i cili program do të mobilizojë mbi 1 miliardë euro gjatë vitit 2020 dhe 2021 që do të futen në ekonomi. Do të themelohet Fondi për Rimëkëmbjen Ekonomike pas Pandemisë COVID-19, ku do të grumbullohen mjetet që do të dedikohen për qëllime të mbështetjes ekonomike dhe sociale për të tejkaluar pasojat e pandemisë.

3.1. Masat e menjëhershme për parandalim të daljes së bizneseve nga tregu

Ndikimi ekonomik i kësaj pandemie mund të jetë i paprecedent, sepse në të njëjtën kohë kemi kolapsim të ofertës agregate dhe reduktim të ndjeshëm të kërkesës agregate. Oferta agregate ka kolapsuar pasi shumë firma janë mbyllur me vendime administrative apo si rezultat i shkëputjes së zinxhirit ofertues/prodhues, si dhe kufizimit të lëvizjes të njerëzve/punëtorëve.

Prandaj, do të ndërmerren masa të menjëhershme që, sa më parë, të normalizohet funksionimi i bizneseve, por duke respektuar udhëzimet shëndetësore që të parandalohet përhapja e virusit. Krahas normalizimit të funksionimit të ekonomisë, do të ofrohet mbështetje e menjëhershme financiare për bizneset, për të përballuar kostot minimale të operimit dhe mbijetesës gjatë kësaj periudhe. Këto masa do të parandalojnë daljen e bizneseve nga tregu, duke siguruar që kostot ekonomike dhe sociale të pandemisë të jenë më të ulëta, si për bizneset dhe familjet ashtu edhe për shtetin.

3.2. Masat për rimëkëmbje për 2020 dhe 2021

Ndërkaq, masat për rimëkëmbje ekonomike, që janë paraqitur në tabelën në vijim, do të sigurojnë rimëkëmbje ekonomike në pjesën e dytë të këtij viti dhe më 2021. Këto masa do të mobilizojnë të gjitha burimet e financimit për bizneset. Do të punohet me bankat që financimi afatgjatë i shtetit për biznese të rrjedhë kryesisht përmes bankave. Kështu që, kjo pandemi duhet parë edhe si një mundësi për ndryshime të mëdha cilësore në strukturën ekonomike të Kosovës, me potencial për rritje afatgjate cilësore. Përmes kanalizimit të fondeve në ekonomi aty ku ka nevojë dhe ku efekti është maksimal, do të krijojnë një momentum të ri për zhvillim të hovshëm ekonomik, duke e vendosur ekonominë e Kosovës

në një trajektore më të lartë të rritjes dhe zhvillimit afatgjatë, me punësim më të lartë dhe më cilësor.

Masa	Qëllimi i masës dhe përshkrimi	Nënmasa	Implikimet ligjore	Institucionet zbatuese dhe përkrahëse
1. Lehtësimi i qasjes në financim	Lehtësimi i qasjes në kredi për ndërmarrjet private, për të financuar projekte investive dhe vazhdimin e operimit.	<ul style="list-style-type: none"> a. Rritja e mbulueshmërisë së kredive të reja përmes Fondit për Garantimin e Kredive, b. Riprogramimi i kredive bankare ekzistuese, ku koston e riprogramimit e merr Qeveria, c. Subvencionimi i normave të interesit për sektorë të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga akterët relevantë. 	<p>Konsultim me BQK-në për ndryshimet e nevojshme rregullative që duhet të ndodhin për zbatimin e këtyre masave.</p> <p>Nënshkrimi i memorandumëve të bashkëpunimit në mes BQK-së, Qeverisë dhe institucioneve financiare për zbatimin e masave.</p>	MF, BQK, MTI/Fondi për Garanci Kreditore, Bankat Komerciale, Odat Ekonomike
2. Zvogëlimi i barrës tatimore	Lehtësimi i barrës tatimore të bizneseve, për të përmirësuar likuiditetin e tyre afatshkurtër.	<ul style="list-style-type: none"> a. Shtyrje e pagesës së tatimeve bazuar në nevojat e bizneseve, b. Mbulimi i 5-përqindëshit të kontributit pensionale që biznesi paguan për punëtorë, c. Pushimet tatimore për firmat për sektorë të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga akterët relevantë, d. Lirimet për parapagimet e obligimeve tatimore nga ana e bizneseve. e. Lirimi i bizneseve nga ndëshkimet tatimore për vonesa në pagesën e tatimeve për shkak të pandemisë bazuar në kriteret e qarta dhe transparente. 	Ndryshimi i rregullativës ligjore të fushës së tatimeve dhe kontributeve pensionale, si dhe përgatitja e planit strategjik për mbështetje sektoriale.	Kuvendi, ATK, Doganat, MF, Trusti Pensional i Kosovës, Odat Ekonomike, komunat.

		f. Ofrimi i mundësisë për riprogramim të borxheve tatimore të mëparshme, duke përfshirë edhe zbritjet për pagesën e menjëhershme të borxhit.		
3. Masat për mbështetje të punësimit	Rritja e punësimit, në veçanti e grupeve specifike të punëtorëve me gjasa më të ulëta për punësim.	a. Subvencionim i pagës për punëtorët në biznese të prekur nga pandemia, b. Subvencionim i pagës për punëtorët e rinj që marrin bizneset në punë bazuar në një plan që identifikon sektorët dhe kategorinë e punëtorëve më në nevojë, c. Përkrahja profesionale për biznese për funksionim në kushte pandemie, siç është puna nga shtëpia, puna online, transformimi digjital etj.	Përgatitet plani strategjik për zbatimin e masave, ku përcaktohen kriteret dhe procedurat për mbështetje të bizneseve për rritje të punësimit.	MPMS, MTI, MF, Odat Ekonomike, komunat.
4. Bujqësi	Rritja e prodhimit bujqësor vendor, për të rritur punësimin në zonat rurale, për të zvogëluar importin e produkteve bujqësore dhe rritur sigurinë e ushqimit sipas standardeve të BE-së.	a. Dyfishimi i buxhetit për bujqësi bazuar në Programin për Zhvillim Bujqësor, b. Rritje e ndjeshme e subvencionimit për hektarë dhe për kokë të bagëtive. c. Mbështetje për shitje të produkteve bujqësore, në veçanti qumështin e freskë, pemët dhe perimet e freskëta, d. Zhvillimi i tregjeve lokale bujqësore dhe digjitalizimi i tyre, e. Mbështetje specifike në përpunimin e produkteve bujqësore dhe në ngritjen e kapaciteteve deponuese, f. Subvencionimi i normave të interesit të kredive në bujqësi.	Rishikimi i Programit për Zhvillimin Bujqësor ku parashihen masat, kriteret për zbatim dhe mekanizmat e tjerë të nevojshëm.	MBPZHR, MF, Bankat komerciale, shoqatat e bujqve, komunat.
5. Masat për stimulim të	Rritja e shpenzimeve të konsumatorëve, e cila nxit prodhimin	a. Kthimi i një përqindjeje të mjeteve të kursyera në Trustin Pensional për	Rregullativa ligjore për kontributet pensionale, si dhe	Kuvendi, MF, Trusti Pensional,

kërkesës agregate	dhe punësimin me efekte multiplikuese në ekonomi.	kontributpaguesit, bazuar në nevojat e tyre, e cila mundësi mund të shfrytëzohet për një periudhë 3-mujore, e cila shumë kompensohet nga shteti brenda 5 viteve, b. Mbështetje për zgjatjen e greis periudhës për blerje të banesave dhe shtëpive bazuar në kritere të të ardhurave.	përgatitja e planeve strategjike ku përcaktohen kriteret për mbështetje financiare për financimin e greis-periudhës.	BQK, Bankat komerciale.
6. Mbështetje për ndërmarrje publike për operim të rregullt dhe investime kapitale të rëndësisë strategjike	Mbështetje e operimit dhe investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike, në veçanti ato investime që janë të natyrës strategjike, që të përballojnë uljen e të hyrave nga inkasimi dhe investimet e nevojshme kapitale që duhet të ndërmarrin.	a. Mbulimi i kostove minimale operative të ndërmarrjeve publike, b. Rishikim i planit dinamik të investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike dhe vlerësimin i investimeve të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve publike. c. Mbështetje e investimeve të ndërmarrjeve publike përmes subvencionimit nga buxheti, huadhënies nga buxheti dhe lëshimit të garancioneve sovrane për kreditë që ndërmarrjet publike marrin institucionet financiare.	Përgatitja e planit për mbështetje për likuiditet afatshkurtër për ndërmarrjet publike. Përgatitja e planit strategjik për investime të ndërmarrjeve publike për periudha afatgjata. Ndarja e mjeteve përmes rishikimit të buxhetit.	Kuvendi, MEA, MF, Ndërmarrjet publike, komunitat.
7. Rishikimi i buxhetit për 2020 dhe relaksimi i kufizimeve fiskale dhe i borxhit publik	Rishikimi i buxhetit për vitin 2020 duhet të ndodhë për të marrë në konsideratë ndikimin e pandemisë në të hyrat buxhetore dhe rishpërndarjen e shpenzimeve bazuar në prioritetet e reja. Krahas ndryshimit të ligjit të buxhetit, duhet ndryshuar edhe Ligjin e Financave Publike për të pezulluar përkohësisht rregullat e deficitit buxhetor prej 2%	a. Identifikimi i hendekut tatimor, b. Identifikim i kursimeve, c. Rishpërndarja e shpenzimeve sipas prioriteteve, d. Pezullimi i rregullës fiskale të deficitit prej 2% për tre vite, e. Rritja e kufirit të borxhit publik nga 40% në 50% të PBB-së.	Ndryshimi i ligjit të buxhetit, të ligjit të financave publike dhe ligjit të borxhit publik.	Kuvendi, Qeveria, Komunitat.

	për tre vite, si dhe Ligjin për Borxhin Publik për të rritur kufirin e borxhit publik nga 40% në 50% të PBB-së.			
8. Masa mbështetëse për ekonomi nga sektori financiar	Në konsultim dhe në dakordim me sektorin financiar, do të shikohet mundësia se cilat masa mund të ndërmerren nga BQK-ja për të mbështetur ekonominë, përmes rritjes së kredihënies dhe depozitave, por në të njëjtën kohë duke siguruar qëndrueshmërinë e sektorit financiar si tërësi. Në veçanti do të shikohet sektori i sigurimeve për të rritur pjesëmarrjen e tij në sektorin financiar, për të marrë përsipër ofrimin e një game më të gjerë të shërbimeve siguroese që mbështesin zgjerimin e bizneseve, investimeve dhe transaksioneve biznesore në vend dhe jashtë.	a. Rishikimi i nivelit të kapitalizimit të nevojshëm për akterët financiar, b. Rishikimi i rezervës minimale të likuiditetit detyrueshme, c. Mbështetje për kompanitë e sigurimeve për diversifikim të gamës së shërbimeve siguroese.	Ndryshimet e rregullativës së BQK-së	BQK, Bankat komerciale, kompanitë e sigurimeve, shoqatat e bankave dhe të kompanive të sigurimeve.
9. Mobilizimi për financimin e masave	Mobilizimim i fondeve për financim të masave për rimëkëmbje ekonomike, përmes: buxhetit, duke rishikuar projeksionet buxhetore, deficitin buxhetor dhe borxhin publik; financimit nga donatorët; nga borxhi publik i brendshëm nga letrat me vlerë dhe kreditë e jashtme; financimit të projekteve përmes partneritetit publiko-privat etj.	Mobilizimi i 1.2 miliardë eurove për mbështetje ekonomike për 2020 dhe 2021: a. 180 milionë euro kursime nga buxheti i vitit 2020, b. 51.6 milionë nga FMN, c. 100 milionë nga Komisioni Evropian, d. 120 milionë nga Banka Botërore, e. 60 milionë nga mjetet e privatizimit, f. 100 milionë nga emetimi i letrave me vlerë,	Rishikimi i buxhetit të vitit 2020. Mobilizimi i mjeteve nga borxhi i brendshëm përmes letrave me vlerë dhe borxhi i jashtëm përmes kredive nga institucione financiare ndërkombëtare.	Qeveria, Kuvendi, komunat, donatorët, bankat zhvillimore ndërkombëtare, diaspora.

		<p>g. 20 milionë nga emetimi i letrave me vlerë nga diaspora,</p> <p>h. 300 milionë euro kredi ndërkombëtare për financim të projekteve kapitale të ndërmarrjeve publike, komunave dhe të nivelit qendror,</p> <p>i. 100 milionë euro garancione kreditore për projekte investive prodhuese,</p> <p>j. 170 milionë euro kthime të kursimeve pensionale për kontribut-paguesit nga Trusti Pensional.</p>	<p>Përgatitje e Strategjisë së Borxhit Publik për një periudhën afatgjatë, për të siguruar financim adekuat dhe qëndrueshmëri fiskale.</p>	
--	--	---	--	--

Masat e parapara për rimëkëmbje ekonomike do të realizohen në bashkëpunim të ngushtë me:

- Asociacionet e Biznesit, si në identifikim të problemeve, ashtu edhe në zbatimin e masave nëpër sektorë të caktuar, duke marr parasysh specifikat e sektorëve,
- Komunitet, në veçanti në realizimin e masave në sektorin e bujqësisë, duke i targetuar regionet dhe lokalitetet më të prekura,
- Bankën Qendrore të Kosovës, për të siguruar qëndrueshmërinë e sektorit financiar, rritur potencialin kreditor të bankave dhe diversifikuar riskun nga kredidhënia,
- Institucionet ndërkombëtare, siç janë FMN, Banka Botërore, Komisioni Evropian, si dhe organizatat e tjera që operojnë në Kosovë (UNDP, USAID, GIZ etj.), për krijimin e singergjisë nga ky bashkëpunim dhe për absorbimin sa më efikas të asistencës teknike dhe financiare,
- Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, përfaqësuesit e vendeve të QUINT-it, si dhe përfaqësuesit e tjerë diplomatik në Kosovë,
- Shoqërinë civile dhe mediat, si partnerë shumë të rëndësishëm për ofrimin e ekspertizës së nevojshme dhe për informimin e qytetarëve.

4. QEVERISJA, REFORMA INSTITUCIONALE DHE KOHEZIONI SHOQËROR

4.1. Qasja ndaj reformës institucionale të administratës publike

Qeveria ka si orientim që të ndërtojë një administratë optimale për nga madhësia, duke eliminuar struktura të panevojshme, përfshirë rishikimin funksional të institucioneve, agjencive, dhe organeve të tjera të pavarura. Për këtë qëllim, do të përgatitet ligji për qeverinë, ku do të përcaktohet përbërja e qeverisë dhe kriteret për institucionet vartëse të ministrive.

Do të avancohet reforma në administratës publike, në funksion të përafrimit të qeverisjes me qytetarin, duke funksionalizuar plotësisht E-qeverisjen, për të lehtësuar qasjen në shërbime në të gjithë resorët qeveritarë, si dhe kushtet për funksionim adekuat dhe optimal të pushtetit lokal.

Ndryshimet e legjislacionit, që prekë interesat e komuniteteve joshumicë, do të bëhen në konsultim të ngushtë dhe me përfshirje të përfaqësuesve të komuniteteve. Kujdes të veçantë do t'i kushtohet ofrimit të shërbimeve të administratës shtetërore, në nivel qendror dhe lokal, në gjuhën e komuniteteve joshumicë, në përputhje me ligjet në fuqi. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të punohet në drejtim të përfaqësimit adekuat të komuniteteve joshumicë në të gjitha nivelet e administratës shtetërore dhe ndërmarrjet publike, në veçanti për komunitetet e nën përfaqësuar.

Do të punohet për zbatimin e plotë të pakos së reformës së administratës publike, për uljen e barrierave administrative dhe për rregullimin e fushës së inspektimeve. Krahas procesit të draftimit të Ligjit për Qeverinë, do të analizohen në hollësi funksionet e sektorëve qeverisës, duke shmangur fragmentimin dhe dyfishimin e politikave dhe buxheteve. Plani i punës së Qeverisë do të ketë fokus të veçantë në zbatimin e obligimeve që burojnë nga MSA-ja, ku janë të përfshira një numër i caktuar i reformave institucionale që duhet të ndodhin. Plani i punës i Qeverisë do të sigurojë integrimin e veprimeve sektoriale, buxhetore dhe vendimmarrëse sa i përket reformës ndërinstitucionale dhe bashkëveprimit të nevojshëm që duhet të ndodhë.

4.2. Bashkëpunimi me pushtetit lokal

Do të punohet nga afër me pushtetin lokal, për koordinimin e të gjitha reformave institucionale dhe legjislative. Me komunat do të punohet në veçanti në përgatitjen e buxhetit vjetor, planeve investive në fusha të ndryshme, në shpërndarjen e subvencioneve për bujqësi, si dhe në zhvillimin dhe zbatimin e planin për rimëkëmbje ekonomike pas pandemisë. Së bashku me komunat do të hartohet planet afatgjate për investime në projekte të rëndësishme lokale dhe nacionale, siç janë akumulimet ujore, planet në turizëm, impiantet e ujërave të zeza, infrastruktura kyçe etj. Do të punohet me komunat në identifikimin e ndryshimeve që duhet të ndodhin legjislacionin që prek pushtetin lokal.

4.3. Partneriteti me shoqërinë civile dhe mediat

Qeveria e re do të angazhohet për partneritet substancial me shoqërinë civile, mediat dhe palët e tjera me interes, duke i përfshirë në diskutime për zhvillimin e legjislacionit dhe politikave publike, që nga procesi i hartimit, miratimit, zbatimit, dhe deri në procesin e vlerësimit të ndikimit. Për këtë qëllim do të krijohet një mekanizëm koordinues i konsultimit paraprak të procesit të vendimmarrjes dhe përfshirje në hartimin e legjislacionit, bazuar në kalendarin e vendimmarrjes.

Qeveria e re do të angazhohet për avancimin e lirisë së shprehjes dhe të lirisë së mediave, duke ofruar qasje dhe mbrojtje institucionale e ligjore për mediat. Në bashkëpunim me komunitetin e mediave, do të hartohet rregullativa ligjore për mediat online dhe për rrjetet sociale, duke krijuar kushte për funksionimin më të mirë të tregut të mediave në Kosovë dhe duke parandaluar rrezikun nga lajmet e rreme dhe “media jo ekzistuese”. Në këtë proces, do të zbatohen praktikrat dhe standardet e BE-së. Do të punohet në avancimin e pavarësisë financiare të mediave publike në përputhje me standardet evropiane.

4.4. Luftimi i korrupsionit dhe i krimit të organizuar

Qeveria do të angazhohet fuqishëm në luftimin e korrupsionit. Në kuadër të kompetencave të saj kushtetuese dhe ligjore, Qeveria do të mbështesë, në të gjitha format, institucionet kompetente kundër kësaj dukurie negative. Qeveria do të përmirësojë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rajonal në luftën kundër krimit të organizuar. Për arritjen e këtyre objektivave, do të fuqizohen mekanizmat institucionalë në përputhje me standardet ndërkombëtare sa i përket kodeve të sjelljes të institucioneve përkatëse.

4.5. Përmirësimi i procesit zgjedhor

Qeveria do të ndërmarrë iniciativa për ndryshimin e legjislacionit të zgjedhjeve, për të avancuar standardet dhe përmirësuar administrimin e procesit zgjedhor. Legjislacioni i ri zgjedhor do të garantojë zbatimin e plotë të parimeve kushtetuese dhe parimeve të demokracisë përfaqësuese. Ndryshimet legislative do të adresojnë gjithashtu edhe një sërë problemesh që po paraqiten gjatë administrimit të procesit zgjedhor, përfshirë këtu pastrimin e listave të votueseve, procedurat për votim nga jashtë, menaxhimi i ditës së zgjedhjeve, afatet e ankesave..

4.6. Promovimi i barazisë shoqërore

Qeveria do të jetë e përkushtuar në respektimin e të drejtave civile, politike, ekonomike dhe sociale të të gjithë qytetarëve pa dallim, ashtu siç janë të garantuara me Kushtetutë. Qeveria do të avancojë kornizën ligjore dhe institucionale në funksion të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Qeveria do të fokusohet avancimin e të drejtave të fëmijëve, avancimin social e kulturore të grupeve më në nevojë të shoqërisë dhe rregullimin e organizimit sindikal në përputhje me standardet e ekonomive të tregut. Qeveria do të angazhohet në fuqizimin e të drejtave të patjetërsueshme në pronë, si parim universal për të gjithë pa përjashtim.

4.7. Të pagjeturit dhe viktimat e dhunës seksuale nga lufta

Qeveria e Kosovës do të intensifikojë presionin për zbardhjen e rasteve të personave të zhdukur, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Në këtë kontekst, do të intensifikohet puna e institucioneve kompetente në sigurimin e informatave për lokacionet e reja apo përmbylljen e rasteve të hapura, si dhe trajtimi sa më parë i mbetjeve mortore. Qeveria e Kosovës do të trajtojë me prioritet viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, duke siguruar mbrojtjen institucionale të kësaj kategorie nga stigmatizimi shoqëror.

4.8. Fuqizimi i pozitës së femrave në shoqëri

Qeveria do të fokusohet në fuqizimin e rolit dhe të pozitës së femrave në shoqëri, sidomos avancimit të pozitës së tyre në pozitat vendimmarrëse, në të drejtën e pronës dhe avancimin e saj ekonomik dhe arsimor, duke zbatuar politika adekuate me qasje ndër sektoriale dhe të përcjella me resurse adekuate për zbatim efikas.

5. ZHVILLIMI EKONOMIK GJITHËPËRFSHIRËS DHE I QËNDRUESHËM

Zhvillimi ekonomik do të mbështetet në sektorin privat, i cili është bazë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Do të punohet për krijimin e kushteve për punësim të qëndrueshëm dhe dinjitoz, duke promovuar konkurrencën e lirë, me rol të kufizuar të shtetit në ekonomi, kryesisht si lehtësues e rregullator i zhvillimit ekonomik, bazuar në prioritetet nacionale zhvillimore, me kujdes të veçantë ndaj mjedisit, për ta ruajtur atë edhe për brezat e ardhshëm.

Në këtë drejtim, Kosova e ka të domosdoshme përgatitjen e një orientimi të qartë strategjik afatgjatë të zhvillimit, ku vendosen prioritetet zhvillimore dhe kornizat e politikave ekonomike, fiskale e buxhetore dhe të borxhit publik që tejkalojnë një mandat qeverisës. Një dokument i tillë do të shërbejë si një Kod Ekonomik, i cili përmban parimet për politikat ekonomike dhe shërben si kornizë e legjislacionit të fushës së ekonomisë dhe të procedurave që zbatohen për mbështetje të zhvillimit ekonomik. Një qasje e tillë siguron gjithëpërfshirje dhe integrim në zhvillim me efekte sinergjie.

5.1. Sektorit privat

Për të fuqizuar sektorin privat, si gjenerator i punësimit, do të ndërmerren këto masa:

- Rritja e kapaciteteve të inkubatorëve të biznesit, në veçanti për firmat në sektorin e shërbimeve.
- Funkcionalizimi i zonave industriale nëpërmjet avancimin të menaxhimit të tyre.
- Fuqizimi i të drejtave të pronësisë industriale.
- Rritja efikasitetit të sistemit të drejtësisë dhe të mbrojtjes së investitorëve.
- Fuqizim i Fondit Zhvillimor dhe skemës garantuese për kredi.
- Mbështetje mbështetëse për ndërmarrjet e orientuara drejt eksportit dhe ato në sektorët e mallrave të tregtueshme, të cilat masa ndikojnë në përmirësimin e bilancit tregtar, përfshirë mbështetjen për certifikim për standardet e cilësisë, në veçanti.
- Skema mbështetëse për ndërmarrjeve vendore që përgatiten si furnitorë lokal potencial, si dhe organizimi i vizitave blerëse të kompanive evropiane në Kosovë.
- Riorganizimi i Fondit për Inovacione për të ofruar grante për investime për NVM që bëjnë inovacione.
- Fuqizimi i instrumentit "Skema Vaucher" për Inovacione, duke ofruar financim për avancim profesional për firmat inovative.
- Krijimi i kornizës ligjore që rregullon mënyrën e shpërndarjes së granteve në mënyrë transparente, të paanshme dhe mbi baza konkurruese, përfshirë kriteret për mbështetje të bizneseve në lokalitetet ku jetojnë komunitetet jo shumicë që janë më në nevojë për punësim.
- Zhvillimi i shërbimit këshillimor për biznese përmes nëpërmjet Agjencive të Zhvillimit Rajonal për hulumtime tregu, menaxhim financiar, studime të fizibilitetit, strategjitë e shitjes dhe shpërndarjes etj.
- Ofrimi i asistencës teknike dhe këshillimore për ndërmarrje për zbatimin e MSA-së.
- Përkrahje financiare për biznese për të rinjtë, femrat dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë.
- Rritja e skemave për garantimin e kredive duke i marrë në konsideratë prioritetet sektoriale.

- Integrimi i bazës së të dhënave të sistemit të regjistrimit të kredive me Administratën Tatimore, kompanitë publike dhe me regjistrin e bizneseve, në mënyrë që të përmirësohen informatat përmes të cilave vlerësohet risku i kredive.
- Zhvillimi i tregut të sigurimeve dhe integrimi i tyre në tregje rajonale me qëllim të zvogëlimit të rrezikut përmes diversifikimit.
- Zhvillimi i një Strategjie Kombëtare të Konkurrueshmërisë, e cila do t'i identifikojë intervenimet strategjike për rritjen e konkurrueshmërisë së NVM-ve.
- Krijimi i rrjetit të furnizuesve dhe nën-kontraktorëve përmes organizimit të rregullt të takimeve në mënyrë që të mund të krijohen dhe forcohen lidhjet në zinxhirët e vlerës.
- Ndërtimi i modeleve zhvillimore të bizneseve sipas përvoja të BE-së, ku integrohen qendrat inovative dhe trajnuese, rajonet me zhvillim intensiv bujqësorë dhe kooperativat bujqësorë.
- Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të Autoritetit të Konkurrencës për të fuqizuar konkurrencën në treg.

5.2. Politikat tatimore

Politikat tatimore do të avancohet për të siguruar mbledhje efikase të të hyrave, shpërndarje të barabartë të barrës tatimore dhe luftim të informalitetit. Ndër masat kryesore janë:

- Themelimi i Agjencisë së të Hyrave, përmes bashkimit të ATK-së dhe Doganës, e cila do të mundësojë thjeshtësim të proceseve dhe kosto më të ulët për tatimpagues, duke integruar shërbimet e përbashkëta të hetimeve, inteligjencës, analizës dhe vlerësimit të rrezikut, duke ulur kështu hendekun tatimor.
- Krijimi i strukturave për mbledhjen e TVSH-së brenda vendit.
- Avancimi i sistemit për rimbursimeve.
- Nxitja e bizneseve që të veprojnë në sektorin formal duke thjeshtuar procedurat e deklarimeve tatimore dhe rritur përfitimet e operimit në sektorin formal.
- Plotësimi i bazës ligjore primare dhe sekondare tatimore.
- Ngritja e kapacitetet institucionale për ta mbikëqyrur funksionimin e ekonomisë.

5.3. Shpenzimet publike dhe madhësia e sektorit publik

Qeveria do të angazhohet për shpenzime publike që sigurojnë efikasitet të funksionimit të sektorit publik, duke mos e ngarkuar ekonominë, me madhësi optimale të sektorit publik në përputhje me përvojat e vendeve me ekonomi tregu të krahasueshme me Kosovën. Në mes tjerash, do të ndërmerren këto masa:

- Shpërndarje e barabartë e investimeve publike për të gjithë qytetarët.
- Deficiti buxhetor i menaxhueshëm, borxh publik në kontroll dhe kufizim i ngarkesës së ekonomisë vendore me borxh publik.
- Përfitimet e atyre që përfitojnë nga fondet publike do të jenë në përputhje me rritjen ekonomike të vendit.
- Qeveri e vogël dhe shpenzime më të ulëta.
- Funkcionalizimi i plotë i prokurimi elektronik në shpenzimin e parasë publike.

- Implementimi i projektit të E-Qeverisjes në të gjitha nivelet, ku në arsim do të ndërlihen të dhënat për shkolla në të gjitha komunat për ta përcjellë progresin e nxënësve në secilën shkollë, efikasitetin e funksionimit të shkollave, punën e mësimdhënësve etj. Ndërkaq, në shëndetësi do të finalizohet sistemi informativ shëndetësor.
- Ngritje e efikasitetit në shpenzimet për transferet sociale.
- Rishikim i kabinetit qeveritar, përfshirë edhe agjencitë e pavarura, për të reduktuar madhësinë e administratës publike dhe evituar dualizmin e institucioneve.

5.4. Zvogëlimi i ekonomisë joformale

Nëpërmjet një pakoje të re tatimore, do të nxiten bizneset të veprojnë në sektorin formal të ekonomisë. Do të plotësohen zbrazëtitë ligjore, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Do të fuqizohen kapacitetet institucionale për ta mbikëqyrur funksionimin e ekonomisë. Do të rritet bashkëpunimi ndërinstytucional për të siguruar se bizneset operojnë në sektorin formal. Në sektorin e ndërtimtarisë në veçanti, ku ekonomia joformale është e lartë, do të ndërtohet një sistem kompleks i mbikëqyrjes së kompanive sa i përket punësimit të punëtorëve, qarkullimit të mallrave ndërtimore dhe kryerjes së punëve ndërtimore. Në sektorin e hotelarisë, do të mbikëqyret dhe krahasohet punësimi i punëtorëve, qarkullimi i të ardhurave dhe i mallrave të përdorura për të vlerësuar raportimin e drejtë të tatimit. Në sektorin e shërbimeve (avokatët, shëndetësi, kontabilistët, auditorët, zhvilluesit e programeve softverike, arkitektët, agjencitë e ndryshme, profesionet e tjera shërbyese etj.) do të futen në sektorin formal nëpërmjet një njësie të veçantë të administratës tatimore, e cila do t'i mbikëqyrë këto veprimtari.

5.5. Mbështetja e biznesit për të zvogëluar kostot e prodhimit dhe të funksionimit

Do të ndërmerren investime të mëdha në transportin hekurudhor, mbështetur edhe në donacione dhe kredi të buta ndërkombëtare, për të funksionalizuar plotësisht rrjetin ekzistues të hekurudhave për transport të mallrave dhe të udhëtarëve. Do të përgatitet projekti për lidhjen hekurudhore me Shqipërinë dhe do të kërkohen fonde jopublike për ndërtimin e tij nëpërmjet donacioneve, kredive të buta, partneritetit publik-privat dhe formave të tjera. Do të përgatitet strategjia që nxit transportin e mallrave nëpërmjet hekurudhës, e jo nëpërmjet rrugëve, duke ulur taksat për biznese për shfrytëzimin e transportit hekurudhor. Do të investohet për ndërtimin e stacionit intermodal në mes të Prishtinës dhe Fushë Kosovës, ku sigurohet ndërlidhja e stacionit të trenit për udhëtarë, të stacionit të autobusëve, lidhja me autostradë, transporti i mallrave etj. Do të ofrohet furnizim stabil dhe i qëndrueshëm me energji elektrike, duke ndërtuar kapacitete të reja gjeneruese dhe lidhje me rrjetet energjetike të vendeve fqinje. Do të promovohen alternativat e reja për furnizim me energji dhe gaz natyror.

5.6. Eliminimi i barrierave ligjore dhe zvogëlimi i burokracisë

Korniza ligjore do të vlerësohet në baza të rregullta për efektet e saj dhe të ndryshojë në përputhje me zhvillimet në treg. Do të rritet roli i autoriteteve lokale në ofrimin e lehtësirave të të bërit biznes, duke mundësuar kornizë ligjore të decentralizuar dhe diskresion të nevojshëm të autoriteteve lokale, për të nxitur garën e tyre në tërheqje të

bizneseve në lokalitetet e tyre. Regjistrimi i bizneseve do të decentralizohet, me përfshirje edhe të odës ekonomike. Autoritete lokale do të kenë kompetenca të zgjeruara për dhënien e tokave me qira për investitorë në përputhje me kriteret që përcaktohen me ligje dhe udhëzime administrative të veçanta nga ana e institucioneve qendrore. Do të eliminohen të gjitha monopolet.

5.7. Ndërmarrjet publike dhe privatizimi

Do të rritet efikasiteti i funksionimit dhe qëndrueshmëria financiare e ndërmarrjeve publike. Do të rishikohet baza ligjore për përmbyllje të plotë të procesit të privatizimit. Në mesin e masave që do të ndërmerren hyjnë:

- Fuqizimi i plotë i institucionit të konkursit nëpërmjet të involvimit të institucioneve të pavarura në përzgjedhje (Ambasada Britanike dhe forma tjera).
- Zhvillimi i analizave të rrezikut lidhur me ndikimin e ndërmarrjeve publike në buxhet dhe në ekonomi.
- Futja e sistemit të menaxhimit bazuar në objektiva në vlerësimet e performancës së organeve qeverisëse të ndërmarrjeve publike, duke konsideruar edhe përfshirjen e komunitetit ku vepron ndërmarrja publike përmes avancimit të modelit të qeverisjes korporatave që merr parasysh këtë aspekt.
- Eliminimin e burokracisë në ndërmarrjet publike që operojnë në tregje konkurruese, duke rishikuar legjislacionin përkatës.
- Qartësim dhe rritje e përgjegjësisë që menaxhmenti dhe bordet e ndërmarrjeve publike mbajnë në raport me aksionarin.
- Për secilën ndërmarrje publike do të vendosen indikatorët kyç të performancës, në mënyrë që menaxhmenti dhe bordet e këtyre ndërmarrjeve të mbahen përgjegjës për punën e tyre.
- Auditim i ndërmarrjeve publike nga Zyra Kombëtare e Auditimit me fokus në auditim të proceseve dhe performancës.
- Transferim i përgjegjësisë për mbikëqyrje të ndërmarrjeve publike nëpër ministritë përkatëse.
- Rishikim i strukturës pronësores të disa ndërmarrjeve publike që subvencionohen nga buxheti shtetëror, duke gjetur format që të futet kapitali privat pa rrezikuar interesin shtetëror.
- Privatizimi/shitja e aksioneve në ndërmarrje publik do të ndodh vetëm në momentet kur privatizimi/shitja e aksioneve si proces do të maksimizonte vlerën e ndërmarrjes dhe përfitimeve tjera që ndërlidhen me procesin.
- Për të gjallëruar operimet në disa ndërmarrje publike, në planin afatmesëm dhe afatgjatë, asetet apo pjesë të aseteve të disa ndërmarrjeve publike do të shiten apo do të privatizohen përmjet Ligjit për Investimeve Strategjike.
- Në Telekomun e Kosovës duhet të konsiderohet privatizimi i pjesshëm me një strategji të qartë pas sanimit të gjendjes aktuale, por para privatizimit duhet të sanohen gjendja e rendë dhe përmirësohet performanca në mënyrë që të rritet atraktiviteti për investitorë strategjik dhe me renome në fushën e telekomunikacionit.
- Pas marrjes në konsideratë të kërkesave të kreditorëve dhe detyrimet e tjera të ndërmarrjeve që janë nën Agjencinë Kosovare të Privatizimit, do të përgatitet strategji se si do të përdoren mjetet nga privatizimi. Në parim, këto mjete do të

përdoren vetëm për investime kapitale në infrastrukturë apo kapital njerëzor, si për projektet energjetike, rivitalizimi i Trepçës etj.

- Bazuar në Kushtetutë dhe në ligjet në fuqi, asetet nën menaxhimin e AKP-së nëpër komuna do të shqyrtohen me kujdes në përputhje me kërkesat e komunave për shfrytëzimin e atyre aseteve për qëllime publike.
- Do të përgatitet një strategji e qartë për përmbyllje të procesit të privatizimit dhe transformimin e AKP-së në një agjenci brenda qeverisë për menaxhim të lëndëve në proces.

5.8. Sistemi financiar

Do të zhvillohen politika për reduktim të transaksioneve me para të gatshme dhe paraja e gatshme e mbajtur jashtë sistemit financiar të depozitohet në sistem.

Do të rritet përfshirja e qytetarëve, sidomos me fokus në zonat rurale, në sistemin financiar të vendit. Do të avancohet baza ligjore për mbrojtje të konsumatorëve të produkteve financiare, konform direktivave të BE-së, si dhe reduktim të kostos në produktet elementare. Do të fuqizohet roli i mbikëqyrës dhe pavarësisë së Bankës Qendrore, duke mundësuar edhe integrimin e saj në mekanizmat ndërkombëtarë, Eurosistem dhe Bankës Qendrore Evropiane. Në periudhën afatmesme, do të përgatiten ligjet e nevojshme për liberalizim të tregut të sigurimeve. Do të krijohen politika për mundësim të inovacionit në industrinë financiare dhe të sigurimeve. Do të diversifikohet tregu i sigurimeve, për të ndihmuar ekonominë. Do të avancohet sistemi i vlerësimi kreditor të Kosovës dhe publikimi i informacionit mbi vlerësimin kreditor të vendit. Do të krijohen kushte që normat mesatare të interesit në vend të bien më tutje. Do të forcohet Fondi për Garantim të Kredive dhe Fondi për Sigurimin e Depozitave. Do të bëhen përpjekje për anëtarësimin e Kosovës në kartonin e gjelbër. Do të krijohet baza ligjore për mbrojtje të konsumatorëve nga normat e larta të interesit në kreditë afatshkurta nga Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare. Do të avancohet teknologjia e informacionit për raportim financiar, pastaj implementimi i nënshkrimit dixhital për të dixhitalizuar sektorin financiar etj.

5.9. Investimet e jashtme

Do të zhvillohen kapacitete për promovim dhe mbështetje të investitorëve strategjikë dhe të huaj, në veçanti tek ata me orientim eksportues. Do të zhvillohet një paketë e veçantë për promovim të investimeve nga diaspora. Do të decentralizohen aktivitetet e promovimit dhe tërheqjes së investimeve te niveli komunal, sidomos te e drejta e dhënies së tokës në shfrytëzim.

5.10. Turizmi

Kosova do të promovohet si destinacion turistik, duke rivalorizuar potencialin turistik, bazuar në standardet ndërkombëtare. Do të ngrihen kapacitetet e sektorit të turizmit për të rritur ofertën turistike. Ngritja e infrastrukturës rrugore, rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe shtigjeve turistike do të mundësojë zhvillimin e turizmit. Do të përgatiten hartat turistike, të thjeshta dhe dixhitale, për secilën komunë (pikat turistike, kulturore, arkeologjike, fetare, sportive etj.). Do të përkrahen ofruesit e shërbimeve turistike nëpërmjet asistencës teknike në krijimin e ofertës turistike. Do të punohet bashkë me

pushtetet lokale për ndërtimin e komplekseve turistike, siç është rasti në Brezovicë ku do të promovohet partneriteti publiko-privat në ndërtimin e qendrës së skijimit. Do të subvencionohet truizmi rural nëpërmjet programit të financimit dhe trajnimit për ofrim të shërbimeve.

5.11. Fondi Zhvillimor-Investiv

Për të mbështetur politikat e zhvillimit ekonomik, do të krijohet Fondi Investiv për financimin e bizneseve vendëse dhe bujqësisë me kushte të volitshme kreditore. Për këtë qëllim do të kompletohet baza ligjore për të siguruar që ky fond zhvillimor menaxhohet në mënyrë profesionale dhe është në funksion të arritjes së objektivave makroekonomikë, që janë ulja e papunësisë dhe varfërisë dhe përmirësimi i bilancit tregtar nëpërmjet stimulimit të prodhimit vendës. Ky fond do të mbikëqyret nga BQK-ja. Mjetet për këtë fond zhvillimor do të sigurohen nga mjetet e grumbulluara nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore.

5.12. Anëtarësimi në organizatat ekonomike ndërkombëtare

Anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare do të bëhet mbi bazën e interesave ekonomike dhe shtetërore. Anëtarësimi në këto organizata mundëson që ekonomia e Kosovës të përfitojë më shumë nga globalizimi i tregjeve, por gjithmonë duke promovuar interesat dhe vlerat e saj bazuar në reciprocitet dhe përfitime të dyanshme për veten dhe partnerët e saj strategjikë. Prioritet do të jetë anëtarësimi në OBT dhe organizata të tjera ekonomike ndërkombëtare. Me rëndësi të veçantë është respektimi i obligimeve që dalin nga anëtarësimi në këto organizata, duke siguruar që tregu kosovar të mbetet i hapur për tregtinë ndërkombëtare, por duke siguruar një treg ku arrihet shpërndarje rritjes ekonomike.

5.13. Teknologjia informative

Do të punohet në përfshirjen e Kosovës në Free Roaming Zone në Europë. Marrëveshjet ndërkombëtare të interkoneksionit të telefonisë mobile do të bëhen me qëllim të arritjes së çmimeve sa më të lira për qytetarët e Kosovës. Do të investohet në teknologjinë dhe infrastrukturën për shërbime moderne telekomunikuese, në përputhje me standardet evropiane, përfshirë modernizimin e kornizës rregullative që mbikëqyrë funksionimin e këtij sektori. Marrëveshjet ndërkombëtare të interkoneksionit të telefonisë fikse dhe shërbimin e internetit do të mbikëqyren në aspektin e sigurisë kibernetike dhe çmimeve konkurruese. Do të stimulohen adaptimi një sistemi arsimor në vend sipas trendeve dhe kërkesave të tregut të teknologjisë, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë në arsim. Trajnime të vazhdueshme për mësimdhënës dhe të papunësuarve për t'u përshtatur me trendet e teknologjisë dhe me kërkesat të tregut. Do të krijohet fondi për kredi për shkollim dhe stimulim të studentëve të dalluar. Do të harmonizohen ligjet vendore të teknologjisë me ligjet ndërkombëtarë, duke përfshirë ligjet për privatësi të të dhënave dhe siguri kibernetike. Do të zbatohen politika stimuluese për institucionet e teknologjisë, kompanive të reja (start-up) si dhe kompanive ekzistuese që merren me teknologji. Do të krijohen stimuj për individët dhe kompanitë që merren me inovacion dhe teknologji të reja.

6. DREJTËSI E PAVARUR DHE EFIKASE

Në fushën e rendit dhe ligjit, Qeveria do të angazhohet që, përmes funksionimit të shtetit ligjor efikas, të rrisë besueshmërinë dhe përkrahjen e qytetarëve në institucionet e vendit. Rritja e besueshmërisë në institucione nënkupton rritje të efikasitetit të punës së institucioneve. Një sistem i tillë i drejtësisë siguron kohezionin e brendshëm socio-ekonomik në tërë Republikën e Kosovës. Qeveria angazhohesh për mbështetje adekuate buxhetore të institucioneve të drejtësisë. Qeveria do të angazhohet për një sistem të drejtësisë mbi parimet kushtetuese, duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancat në mes tyre, që siguron një gjyqësor të pavarur, të drejtë dhe të paanshëm, që respekton hierarkinë e normave juridike.

6.1. Avancimi dhe forcimi i institucioneve të drejtësisë

Qeveria do të jetë e përkushtuar që të respektohen të drejtat civile, politike, ekonomike dhe sociale të të gjithë qytetarëve të Kosovës, pavarësisht nga përkatësia e tyre nacionale, etnike, fetare, raciale apo gjinore, ashtu siç janë të garantuara me Kushtetutë dhe ligj. Barazia e qytetarëve para ligjit, gjykimi i drejtë, mosdiskriminimi, e drejta pronësore, liria e siguria, dinjiteti i njeriut dhe të drejtat e tjera qytetare janë themelet e shoqërisë demokratike dhe proevropiane të Kosovës. Qeveria do të angazhohet për ngritjen e buxhetit për sektorin e drejtësisë dhe sigurisë duke ofruar kushte dinjitoze për punonjësit e këtyre sektorëve.

Si parim, do të promovohet shteti ligjor që është transparencën, përmes forcimit të mekanizmave llogaridhënës. Do të punohet për zbatimin e vetingut institucional, në përputhje me standardet evropiane dhe në bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë ndërkombëtarë nga BE dhe SHBA. Mes masave që do të ndërmerim do të jenë edhe rishikimi i legjislacionit që rregullon sistemin e drejtësisë që lidhet me funksionimin më efikas të institucioneve të drejtësisë, për të siguruar edhe qasjen e lirë dhe të barabartë të qytetarëve në drejtësi. Do të punohet në drejtim të krijimit të strukturave për trajtim efikas dhe me prioritet të çështjeve ekonomike.

6.2. Llogaridhënia dhe efikasiteti i sistemit të drejtësisë

Do të avancohet baza ligjore, në përputhje me standardet evropiane, për rekrutimin e numrit të nevojshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar ekskluzivisht mbi bazën e meritave. Do të krijohet baza ligjore për një sistem të fortë dhe transparent të matjes së performancës në institucionet e drejtësisë, e cila do të jetë baza themelore mbi të cilën gjyqtarët dhe prokurorët do të avancohen. Do të krijohen resurset e nevojshme për trajnim të vazhdueshme dhe të detyrueshme për gjyqtarët dhe prokurorët, me qëllim të profilizimit dhe ngritjes së kapaciteteve të tyre. Do të rritet numri i bashkëpunëtorëve profesionalë në institucionet e drejtësisë për punë më efikase të këtyre institucioneve. Do të krijohet baza e qartë ligjore për rritje të efikasitetit të zbatueshmërisë së vendimeve gjyqësore.

6.3. Legjislacioni dhe zbatueshmëria

Legjislacioni në fushën e drejtësisë do të jetë, përveç në përputhje me standardet evropiane, edhe i zbatueshëm sikurse në vendet evropiane. Do të shqyrtohet mundësia që të krijohet një njësi në Ministrinë së Drejtësisë për hartimin e legjislacionit, i cili në mes tjerash do për nevoja të Qeverisë të shqyrtonte sipas nevojës edhe kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e draftvendimeve të qeverisë.

Zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe nxjerrja e ligjeve të reja do të shoqërohet edhe me mekanizëm për monitorim të zbatimit të ligjeve, si dhe do të punohet që të rritet roli mbikëqyrës i Kuvendit në zbatim të ligjeve.

Do të sigurohet transparencë dhe kontroll mbi komisionet e Ministrisë së Drejtësisë, ku kandidatët do t'u nënshtrohen provimeve për t'u licencuar për ushtrimin e profesioneve të lira (avokat, noter, përmbarues, ndërmjetësues etj.).

Prioritet do të jetë rritja e kapaciteteve të Avokaturës Shtetërore, që përfaqëson të gjitha institucionet pranë organeve gjyqësore, atyre të arbitrazhit, si dhe organeve të tjera të arbitrazhit. Përmes sistemit efikas ligjor dhe menaxhimit adekuat institucional, do të rriten kapacitetet për mbikëqyrje dhe transparencë të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar apo të sekuestruar. Do të miratohet Ligji për Kontrollin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme bazuar në praktikën e vendeve perëndimore.

6.4. Luftimi i korrupsionit, krimeve dhe terrorizimit

Luftimi i pakompromis i korrupsionit, krimeve, terrorizmit dhe aktiviteteve të lidhura me dukurinë e terrorizmit, krimin ekonomik, trafikimit të qenieve njerëzore dhe llojeve të tjera të kriminalitetit do të jetë angazhim i përhershëm i Qeverisë. Në këtë drejtim, do të promovohet profesionalizmi i institucioneve përgjegjëse, duke siguruar mbështetje më të madhe buxhetore.

Qeveria do të angazhohet për rishikimin funksional të institucioneve të hetuesisë dhe mekanizmave të tjerë për të siguruar efikasitet të luftës kundër dukurive negative. Në kuadër të luftës kundër krimin të organizuar, prioritet do të jetë zbardhja e vrasjeve të pazbardhura deri më tani, duke i trajtuar këto raste në mënyrë të paanshme dhe profesionale, duke siguruar punë të pavarur të organeve përkatëse.

7. POLITIKA E JASHTME, INTEGRIMI NË BE DHE DIALOGU ME SERBINË

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, politika e jashtme e Kosovës do të jetë reflektim i politikës së brendshme dhe në funksion të ndërtimit, ruajtjes e thellimit të marrëdhënieve me partnerët tanë strategjikë dhe me shtete të tjera, ruajtjes së sovranitetit, integritetit territorial, rendit kushtetues, lirive dhe të drejtave të qytetarëve të Kosovës brenda dhe jashtë vendit dhe garantimit të sigurisë së saj shtetërore. Orientimet dhe prioritetet kryesore në fushën e politikës së jashtme do të jenë në fushat në vijim.

7.1. Politika e jashtme

Kosova do të flasë me një zë të vetëm në politikën e jashtme dhe Qeveria do të hartojë qëndrimet e politikës së jashtme, të cilat do të promovohen nga të gjitha institucionet. Orientimet dhe prioritetet kryesore në fushën e politikës së jashtme do të jenë në fushat në vijim, të ndara në prioritete politike dhe ato funksionale.

7.1.1. Prioritetet politike

Mbrojtja, forcimi dhe promovimi i sovranitetit shtetëror: Politika shtetërore e Kosovës do të vihet në funksion të mbrojtjes, forcimit dhe të promovimit të sovranitetit shtetëror, integriteti territorial i Kosovës dhe fqinjësisë së mirë, bazuar në orientimin e qartë gjeostrategjik që në thelb është euroatlantik dhe për bazë merr respektimin e Kushtetutës tonë dhe respektimin e së drejtës ndërkombëtare, në linjë me qëndrimet e partnerëve tanë në Evropë dhe përtej Atlantikut. Në këtë aspekt, edhe dialogu me Serbinë do të zhvillohet si një proces në të cilin Kosova dhe Serbia trajtohen si dy palë të barabarta, mbi baza të reciprocitetit të plotë mes palëve dhe në respektim të plotë të së drejtës ndërkombëtare, rregullimit tonë të brendshëm kushtetues dhe i cili për qëllim final ka njohjen reciproke në kufijtë ekzistues dhe anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizatat relevante ndërkombëtare, para se gjithash në OKB, BE dhe NATO.

Partneriteti strategjik me SHBA dhe aleatët e tjerë: Qeveria e Kosovës do të angazhohet për ruajtjen dhe avancimin e marrëdhënieve strategjike me SHBA, duke thelluar partneritetin në të gjitha nivelet. Po ashtu, do të ketë angazhim të shtuar në mirëmbajtjen, thellimin dhe kultivimin e marrëdhënieve me aleatët tjerë ndërkombëtarë.

Konsolidimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës: Do të shtohen përpjekjet për njohjen universale dhe të plotë të pavarësisë së Kosovës. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet pesë vendeve të BE-së që ende nuk e kanë njohur Kosovën (Spanja, Qipro, Sllovakia, Rumania, dhe Greqia), me të cilat do të punohet në koordinim me aleatët tanë strategjik, si dhe duke diversifikuar aktivitetet lotuese dhe aktorët e përfshirë në këtë proces, përfshirë rritjen e shkëmbimeve akademike, ekonomike, kulturore, diplomacinë parlamentare etj. Prioritet do t'i kushtohet edhe shteteve që janë gjeografikisht larg nesh duke intensifikuar raportet tona dypalëshe, përfshirë këtu edhe hapjen e deryeve të komunikimit me shtete me peshë rajonale si Brazili, Indonezia, Nigeria, Meksika, Kenia, Kili dhe shtete të tjera me ndikim në rajone të ndryshme. Ndryshimi i qëndrimit nga këto shtete me peshë rajonale do të ndryshonte qëndrimin e shteteve tjera përreth.

Marrëdhëniet dypalëshe: Do të promovohen marrëdhëniet e mira dypalëshe me të gjitha shtetet e rajonit, Evropës dhe të botës. Fokus të veçantë do t'i kushtojë promovimit të marrëdhënieve speciale dhe strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendeve kryesore në BE-së. Do të promovohen partneritetet strategjike me partnerët tanë, me qëllim të përfitimeve të ndërsjella në ekonomi, siguri dhe në fushat me interes të përbashkët, për të shtyrë përpara integrimin në strukturat Evro-Atlantike. Do të vendosen raporteve dy palësh me shtete në gjeografi të ndryshme të botës. Në fokus do të jetë edhe hyrja në marrëdhënie diplomatike, si parakusht i avancimit të raporteve në fushat e tjera të interesit të dyanshëm. Përveç vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me vendet kyçe në kontinente të ndryshme, Qeveria e Kosovës synon të zhvillojë marrëdhënie përtej atyre tradicionale diplomatike, sikurse inicimin e konsultimeve të rregullta politike, nënshkrimin e marrëveshjeve për heqjen e regjimit të vizave, mbrojtjen e investimeve si një prioritet për të krijuar një bashkëpunim të mirë dhe bazë ligjore të konsoliduar. Qeveria e Kosovës do të angazhohet për zbatimin e obligimeve të marra për korrigjimin e demarkacionit me Malin e Zi (korrigjimin saj në dy segmente, atë të Kullës dhe të Zhlebit) në përputhje me marrëveshjen dhe zotimet e marra në mes të dy shteteve.

Diplomacia ekonomike: Funkcionalizimi i diplomacisë ekonomike do të vihet në shërbim të tërheqjes së investimeve të huaja dhe të promovimit të prodhimeve të Kosovës në botë, në koordinim të plotë ndërinstitucional. Diplomacia ekonomike dhe rritja e investimeve të huaja do të jetë boshti kryesor i Qeverisë, si dhe një ndër prioritetet kryesore të Kosovës sa i përket zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Rrjeti diplomatik në shërbim të zhvillimit do të jetë prioritet, për ta maksimizuar përfitimin shumësektorësh nga Shërbimi i Jashtëm i Kosovës. Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me rrjetin e saj ndërkombëtar të ambasadave dhe konsullatave e, veçanërisht me diasporën shqiptare, do të vazhdojë të kontribuojë në përpjekje më të gjerë, për të sjellë investimet e huaja dhe ato të diasporës në Kosovë e, po ashtu, edhe të promovojë eksportin e Kosovës në botë.

Marrëdhëniet shumëpalëshe: Qeveria do të dinamizojë punën dhe shtojë përpjekjet për t'u bërë anëtare e plotë e NATO-së, BE-së dhe OKB-së (dhe agjencive të saj të specializuara), si dhe të rrisë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e saj në mekanizmat multilateral. NATO-ja do të vazhdojë të jetë instrumenti kryesor multilateral i politikës së mbrojtjes dhe sigurisë së Kosovës në aspektin diplomatik dhe ushtarak. Nëpërmjet përafrimit kontraktual në Partneritetin për Paqe të NATO-s, Kosova do jetë pjesë e kornizës së mbrojtjes kolektive për parandalimin e kërcënimeve të mundshme, sfidave dhe rreziqeve për stabilitetin e vendit dhe të rajonit. Në të gjitha këto përpjekje do të ketë koordinim maksimal ndërinstitucional dhe, po ashtu, me partnerët tanë ndërkombëtarë. Do të ketë planifikim dhe koordinim të kujdesshëm për aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Interpol dhe në agjencitë e specializuara të OKB-së, si në Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSh), Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikimit (ITU), Unionin Postar Universal (UPU), Organizatën për Ushqim dhe Bujqësi (FAO) dhe Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO). Prioritet po aq i rëndësishëm është edhe anëtarësimi në Këshillin e Evropës, si organizata më e rëndësishme panevropiane pas BE-së. Të gjitha synimet e anëtarësimit do të realizohen përmes strategjisë gjithëpërfshirëse, që do të studiojë në detaje rrugët dhe rrethanat politike të procesit të anëtarësimit. Do të intensifikohen përpjekjet për të marrë TOP LEVEL DOMAIN, i njohur si Kodi Shtetëror i Internetit.

Politika ndaj rajonit: Qeveria e re do të promovojë fqinjësi të mirë dhe konstruktive me të gjitha shtetet e rajonit, përmes forcimit të bashkëpunimit bilateral dhe multilateral në forumet dhe në mekanizmat rajonale. Në përmbushje të kësaj politike rajonale, Kosova do të angazhohet në mënyrë konstruktive dhe pragmatike për të rritur bashkëpunimin rajonal efektiv nëpërmjet fuqizimit të pjesëmarrjes së saj në SEECP, Këshillin Rajonal për Bashkëpunim (RCC), Procesin e Berlinit, RACVIAC, MARRI, A5 dhe organizatat dhe iniciativat të tjera të rëndësishme rajonale, në të cilat Kosova është anëtare dhe pjesëmarrëse. Qeveria do të angazhohet për marrëdhënie të mira me të gjitha vendet e rajonit, përfshirë angazhimin për heqjen e regjimit të vizave me Bosnjën dhe Hercegovinën dhe angazhimin për njohje nga ky shtet, përfshirë hapjen e një zyreje ndërlidhëse si hap i parë në Prishtinë dhe në Sarajevë, respektivisht. Lidhur me marrëveshjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, Qeveria do të angazhohet që të respektojë plotësisht marrëveshjen dhe obligimet e mbetura nga marrëveshja.

Diplomacia publike dhe parlamentare: Kosova duhet të vazhdojë të promovojë një imazh real mbi historinë, kulturën dhe identitetin e saj nëpërmjet diplomacisë publike, kulturore dhe digjitale, dhe do të synojë të rrisë ndikimin kulturor dhe akademik në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Në kuadër të dinamizmit të mëtutjeshëm të të gjitha fushave të diplomacisë dhe të politikës së jashtme, duke synuar ndërtimin e imazhit të ri për Kosovën, si dhe avancimin e interesit shtetëror të saj në shoqërinë ndërkombëtare.

Diaspora: Do të ketë qasje të re me diasporën tonë nëpër botë, duke bërë regjistrimin dhe identifikimin e saktë të tyre, në mënyrë që të ndërtojmë e thellojmë lidhje të forta të shtetit të Kosovës me secilin prej tyre, pavarësisht vendndodhjes. Sipas këtij regjistrimi, do të bëhet edhe planifikimi i veprimeve të reja në funksion të interesave strategjike të vendit. Do të synohet hapja e Qendrave Kulturore në kryeqytete/qytete në të cilat ka koncentrim të madh të diasporës, ku edhe do të organizohet jeta kulturore e arsimore e familjeve të tyre, përfshirë këtu edhe mësimin në gjuhën shqipe. Angazhim të veçantë do t'i kushtohet edhe lehtësimit dhe përkrahjes së investimeve strategjike të diasporës në Kosovë, si dhe rikonfigurimin nga 'ikja e trurit' në 'kthim të trurit.'

7.1.2. Prioritetet funksionale

Riorganizimi funksional i MPJD-së: Do të bëhet riorganizimi funksional i Ministrisë, pas fuzionimit me departamentet përgjegjëse për diasporën. Do të rishikohet organogrami aktual dhe do të riformatohet sipas prioriteteve, si dhe aktualitetit politik e funksional të vendit. Do të funksionalizohet dhe riorganizohet Akademia Diplomatike, dhe do të studiohen rrugët ligjore për themelimin e Institutit për Diplomaci.

Rishikimi i infrastrukturës ligjore të ministrisë dhe të shërbimit diplomatik do të bëhet në funksion të organizimit më të mirë dhe të funksionalizimit të plotë të zinxhirit ministror dhe atij diplomatik, gjithnjë duke reflektuar prioritetet shtetërore dhe interesat strategjike të vendit.

Reforma e Shërbimit të Jashtëm: Fokusi i Qeverisë së re do të jetë në profesionalizimin, ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e performancës së anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm për t'u përballur me efikasitet kundrejt sfidave aktuale dhe atyre të së ardhmes. Rivlerësimi i

përgjithshëm i personelit diplomatik dhe konsullor i ngritjes në detyrë, gradë dhe avancimit në karrierë do të ndërmerret me qëllimin e vetëm të profesionalizimit të shërbimit. Do të riorganizohet dhe zgjerohet rrjeti diplomatik në botë, me fokus në hapjen e misioneve diplomatike në vendet e largëta, dhe riorganizimin e misioneve konsullore në Evropë, duke forcuar subjektivitetin e vendit në botë. Do të bëhet depolitizimi i procesit të rekrutimit dhe atij të avancimit në shërbimin diplomatik dhe konsullor. Aplikimi i avancimit meritator dhe rotacionit do të jetë një ndër prioritetet.

Digjitalizimi i shërbimeve konsullore do të planifikohet me kujdes, me qëllim ofrimin e shërbimeve online dhe me kosto më të ultë për qytetarët dhe shtetin.

7.2. Integrimi në BE

Synim parësor i Qeverisë së re është forcimi i subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës, duke ruajtur dhe zhvilluar raporte të qëndrueshme me vendet partnere dhe duke e promovuar Kosovën si një shtet të përgjegjshëm, të gatshëm për të qenë pjesë e organizatave rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare. Në të gjitha politikat e marrëdhëniesve integruese ndërkombëtare do të mishërohet fryma evropiane dhe perëndimore lidhur me liritë politike dhe ekonomike, respektimit të pluralizmit të brendshëm dhe diversitetit dhe kultivimit të frymës institucionale. Në kuadër të kësaj qasjeje, do të dinamizohet plani i zbatimit të MSA-së dhe të gjitha obligimeve të Kosovës në procesin e integritit evropian. Para së gjithash, do të zbatohet një qeverisje e përgjegjshme, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane, që e vë Kosovën në linjë me vendet evropiane dhe që e qartëson dhe shpejton rrugën tonë integruese.

Në veçanti, do të punohet për:

- Përmbjlljen e suksesshme të procesit të liberalizimit të vizave gjatë kryesimit të Presidencës së BE-së nga Gjermania;
- Harmonizimin e plotë të legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së dhe promovimin e politikave publike që janë në përputhje me frymën e integritit evropian;
- Rritjen e pjesëmarrjes së Kosovës në iniciativat, forumet, instrumentet dhe programet për bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar në kuadër të procesit të integritit evropian;
- Rritjen e efektivitetit të gjyqësorit, si parakusht themelor për integrimin evropian dhe veçanërisht për liberalizimin e vizave, duke rritur kapacitetet e gjyqësorit për trajtimin e lëndëve dhe duke respektuar pavarësinë e tij;
- Zvogëlimin e pengesave ligjore, administrative dhe procedurale për zhvillimin e bizneseve, duke çliruar potencialin e sektorit privat për të zhvilluar ekonominë, për ta rritur aftësitë konkurruese të vendit në kuadër të tregtisë së lirë me vendet e rajonit dhe ato të BE-së;
- Promovimin e mobilitetit të rinjve për arsim në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, duke rritur stimulimet për bashkëpunim me partnerët e jashtëm për programe të arsimit, punësimit dhe aftësimin profesional;
- Avancimi i prokurimit publik, menaxhimit financiar dhe reformën e administratës publike, për të rritë transparencën dhe qeverisjen e mirë, si parakushte për arritjen e objektivave drejt anëtarësimit në BE;

- Zhvillimin e dialogut politik me BE-në në të gjitha nivelet e parapara e, në veçanti, në çështjet që rregullojnë aspektet e politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes të BE-së, duke synuar që në vazhdimësi të harmonizojmë qëndrimet tona me ato të BE-së;
- Krijimin e kapaciteteve absorbuese të Kosovës për fondet nga BE-ja dhe partnerët e tjerë të jashtëm, si pjesë të procesit të integritimit evropian dhe zhvillimit të vendit, duke ofruar qeverisje të përgjegjshme, me kredibilitet dhe me dialog të hapur me BE-në dhe partnerët e tjerë.

7.3. Dialogu me Serbinë

Çështjet e interesit të ndërsjellë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë mund të zgjidhen vetëm përmes dialogut. Marrëdhëniet e mira ndërshtetërore janë parakusht për paqe në rajon dhe për procesin e integritimit euroatlantike.

Para fillimit të dialogut për marrëveshje përfundimtare me Serbinë për njohje reciproke në kufijtë ekzistues, do të përgatitet platforma për dialog, ku specifikohen objektivat që duhet të arrihen me marrëveshjen përfundimtare, çështjet për të cilat duhet të përfshihen dhe raportimi dhe transparenca gjatë procesit të arritjes së kësaj marrëveshjeje. Palë negociuese në dialog do të jetë Qeveria, e cila i përgjigjet Kuvendit, ndërkaq Presidenti e përfaqëson vendin në bazë të kompetencave kushtetuese.

Qeveria e re do të angazhohet për dialog ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë si dy shtete të pavarura e që zhvillojnë dialog shtet-me-shtet, për njohje reciproke ndërmjet tyre dhe zgjidhje të çështjeve në mes tyre.

Marrëveshja duhet t'i mundësojë Kosovës anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, para së gjithash në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, si dhe t'i hapë rrugë anëtarësimin të saj në BE dhe NATO. Marrëveshja duhet të përmbajë garancitë politike dhe juridike për implementimin e saj.

Subjektiviteti shtetëror i Kosovës është përcaktuar me Deklaratën e Pavarësisë, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Andaj, territori i Republikës së Kosovës është një dhe i pandashëm dhe asnjë institucion nuk ka mandat të negociojë për territorin, sovranitetin dhe integritetin territorial dhe rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.

Me qëllim që të arrihet një marrëveshje përfundimtare, që rezulton me njohje reciproke në kufijtë ekzistues, Qeveria e vlerëson rolin e Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës si të pandashëm për suksesin e këtij procesi. Përfshirja e plotë në dialog si e BE-së ashtu edhe e SHBA-ve është kyçe, si në arritjen e marrëveshjes, ashtu edhe në garantimin e zbatimit të saj.

Qeveria do të angazhohet për reciprocitet të plotë të të drejtave dhe lirive themelore të shqiptarëve që jetojnë në Luginën e Preshevës dhe serbëve që jetojnë në Kosovë, duke e konsideruar këtë si një nga kushtet thelbësore për zgjidhje të qëndrueshme të çështjeve të interesit të ndërsjellë.

Qeveria konsideron se dialogu për arritjen e marrëveshjes me Serbinë mund të jetë i suksesshëm dhe marrëveshja e zbatueshme vetëm me angazhim e të gjitha forcave politike parlamentare, si dhe me përfshirjen e institucioneve akademike dhe shkencore dhe të shoqërisë civile e mediave si në sigurimin e ekspertizës në këtë proces, ashtu edhe në mbikëqyrjen dhe sigurimin e transparencës karshi publikut dhe qytetarëve.

Qeveria konsideron se Kuvendi duhet të ketë rol të plotë mbikëqyrës të procesit të dialogut, duke angazhuar të gjithë mekanizmat ekzistues parlamentar, apo duke krijuar mekanizma të ri parlamentar në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, për të mbikëqyrur këtë proces. Opozita do të ketë rol udhëheqës në këta mekanizma parlamentar që mbikëqyrin procesin e dialogut.

8. ARSIMI DHE SHKENCA

Arsimi është bazament i zhvillimit të përgjithshëm shoqëror dhe ekonomik. Si parim, secilit qytetar i ofrohet mundësia për arsim dhe aftësim cilësor, të orientuar kah nevojat e tregut të punës me qëllim të rritjes së punësueshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Një sistem modern i arsimit, që është gjithëpërfshirës, cilësor, autonom, i integruar publik dhe privat, duhet t'u ofrojë qytetarëve qasjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës në përputhje me nevojat dhe aftësitë e tyre.

8.1. Pandemia nga COVID-19 dhe përmbyllja e vitit shkollor 2019-2020

Masat e ndërmarra deri më tani nga autoritetet përkatëse arsimore, kanë mundësuar vazhdimësinë e mësimin në kushtet e pandemisë. Për të përmbyllur me sukses vitin shkollor 2019-2020, duhet të bëhet një vlerësim i tërësishëm sesi ka funksionuar mësimdhënia dhe mësimnxënia gjatë kësaj periudhe. Duhet të përgatiten udhëzuesit e nevojshëm për vlerësim të nxënësve dhe studentëve, duke siguruar se janë arritur objektivat kryesore të parapara në kurrikulat përkatëse. Duhet të bëhen të gjitha përgatitjet për mbajtjen me sukses të testit të arritshmërisë dhe testit të maturës dhe provimeve në të gjitha institucionet arsimore. Të gjitha këto veprime duhet të ndërmerren në përputhje me udhëzimet e institucioneve shëndetësore për të siguruar shëndetin publik. Po ashtu, duhet të bëhen përgatitjet dhe adaptimet e institucioneve arsimore për vitin e ri shkollor nën supozimin se masat kufizuese mund të vendosen prapë si rezultat i pandemisë.

8.2. Avancimi i strukturave dhe funksioneve në arsim

Është e nevojshme të ndërmerret një rishikim i strukturës së autoriteteve dhe mekanizmave të arsimit parauniversitar. Kjo për arsye të nevojës që ka arsimi për të qartësuar detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe të trupave mbikëqyrës institucionale në kuadër të ministrisë, si: Agjencia për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, Agjencia e Akreditimit, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Instituti Pedagogjik, Qendra Shtetërore e Testimit, SMIA, Inspektorati i Arsimit, Kolegjiumi i DKA-ve. Fillimisht do të bëhet shqyrtimi i rishikimit funksional të ministrisë dhe agjencive vartëse i kryer nga ekipi i jashtëm i ekspertëve. Në veçanti do të shikohet misioni, struktura dhe funksionimi i Drejtorive Komunale të Arsimit. Në anën tjetër do të rishikohet misioni i sektorit të arsimit dhe i nënsektorëve të caktuar.

Pastaj do të ristrukturohen funksionet e sistemit (licencimi, inspektimi, kurrikula, infrastruktura, zhvillimi i kapaciteteve e të tjera) dhe përgjegjësitë (udhëheqja, menaxhimi, monitorimi, planifikimi) në bazë të misioneve përkatëse për të mbuluar tërë mozaikun e sistemit, duke mos lejuar dyfishime ose fusha të pambuluara. Secili departament i ministrisë do të ketë mision e funksion të qartë, autoritetet vendore arsimore do të angazhohen në fushëveprim dhe funksione të qarta, në përputhje me nevojat dhe kapacitetin institucional, secila agjenci do të ketë misionin e vet dhe funksionin e qartë dhe ndërlidhjen me njësinë përkatëse në ministri dhe në autoritetet vendore, secili institucion edukativ, arsimor, aftësues, shkencor do të ketë funksion, mision dhe fushëveprim të qartë, e kështu me radhë. Një organizim i tillë i qartë do të krijojë sinergjitë në mes të autoriteteve e institucioneve.

8.3. Infrastruktura arsimore

Infrastruktura arsimore duhet të modernizohet dhe të riorganizohet për shfrytëzim më efikas. Fokusi do të jetë në infrastrukturën e cilësisë në arsim, si në kabinete të ndryshme, në salla të edukatës fizike, laboratore, punëtori, biblioteka shkollore dhe infrastrukturë tjetër përcjellës. Do të investohet në modernizimin e infrastrukturës në arsimin e lartë.

8.4. Kurrikula arsimore

Do të ndërmerret në një vlerësim i plotë i kurrikulave arsimore, për të mundësuar mësimnxënie dhe mësimdhënie më të lehtë dhe më efikase, përfshirë këtu rishikimin e politikave për përgatitjen e teksteve mësimore, standardizimin e teksteve mësimore, përgatitjen e udhëzuesve për zbatim të kurrikulave dhe ofrimin e përkrahjes profesionale dhe me jete didaktike. Në këtë drejtim, do të fuqizohen mekanizmat përkatës institucional (si Instituti Pedagogjik, agjencitë përkatëse) në krijimin e kapaciteteve në zhvillimin dhe mbikëqyrjen e vlerësimin e rregullt të zbatimit të kurrikulave.

8.5. Edukimi parashkollor

Edukimi i hershëm është parakusht për zhvillimin e fëmijëve. Zgjerimi i rritit të institucioneve të edukimit parafillor në çdo komunë do të trajtohet me prioritet, përfshirë edhe mënyrën e financimit. Ministria do të ketë rol më të madh në këtë drejtim, duke ndihmuar komunat në planifikimin dhe ndërtimin e rritit të institucioneve parashkollore.

Do të ndërmerren masa të menjëhershme për të rritur rolin e shkollës në përfshirjen në edukimin parashkollor. Kjo do të përmirësojë zhvillimin psiko-social të fëmijëve dhe performancën e tyre në shkollimin e mëtejshëm. Këto kapacitete do të krijohen në bashkëpunim me komunat. Në të njëjtën kohë, do të bëhen përgatitjet e stafit për të punuar me këta fëmijë dhe mjeteve të nevojshme edukative. Një opsion i mundshëm është që të hapen grupe parashkollore për moshën 4-5 vjeçare, në ato shkolla ku ekzistojnë kushtet për një veprim të tillë. Për këtë qëllim mund të riaftësohen mësuesit e shkollës fillore që mbesin tepriçë për shkak të rënies së numrit të nxënësve në këtë nivel të shkollimit.

8.6. Arsimi parauniversitar

Menaxhimi i integruar i shkollës: do të punohet në kthimin e shkollës tek komuniteti dhe në integrimin e plotë së saj në komunitet, duke depolitizuar menaxhmentin e shkollës, duke siguruar kontrata të përhershme për drejtorët e shkollave me vlerësim të rregullt të punës së tyre, duke rritur funksionalitetin e Këshillit të Shkollës, forcuar procedurat e rekrutimit bazuar në meritë dhe konkurrencë. Në këtë mënyrë, shkolla shndërrohet në qendër të transformuese dhe inkubator i zhvillimit të fëmijëve. Shkolla do të kthehet në qendër të zhvillimeve në komunitet, duke fuqizuar zhvillimin e kompetencave të fëmijës në partneritet me familjen. Për këtë qëllim, do të punësohen psikologu i shkollës, koordinatori i cilësisë, sociologu-punëtori social dhe këshilltari për karrierë. Për këto shërbime, do të angazhohen profesionistë të fushës ose do të riaftësohen mësimdhënësit që mbesin pa punë për shkak të rënies së numrit të nxënësve. Pos kësaj, do të fuqizohen kryetarët e aktivave (departamenteve) dhe kujdestarët e klasave. Pastaj, do të sigurohen hapësirat, do të

krijohen kushtet materiale dhe do të hartohen programe për klube për mësim plotësues, për lëndë zgjedhore, dhe aktivitete jashtëkurrikulare, si hapa të parë drejtë mësimi tërëditor në të gjitha shkollat kosovare. Do të analizohet mundësia e zbatimit të pensionimit të parakohshëm të mësimdhënësve në moshë të shtyrë që nuk mund të kryejnë obligimet e tyre arsimore për shkak të problemeve shëndetësore.

Mësimdhënia: Shkollës i duhet një aleancë me mësimdhënësit e përkushtuar. Në këtë drejtim, duhet të rishikohet sistemi të pagave për të shtuar rëndësinë e performancës dhe përkushtimit. Do të zhvillohet fondi për mësimdhënie inovative dhe për stimulim të performancës në mësimdhënie, grante të vogla (1000 €) me bazë në shkollë. Do të ngrihen kapacitetet e menaxhmentit të mesëm në shkolla për të ndihmuar punën e mësimdhënësve dhe drejtorit të shkollës. Do të përkrahen koordinorët e cilësisë. Do të shihen mundësitë për zbatim të testit të obligueshëm shtetëror për të diplomuarit nga fakultetet e edukimit. Do të mbështetet zhvillimi profesional me bazë në shkollë në bazë të nevojave dhe projekteve individuale të mësimdhënësve.

Shkolla si qendër e avancuar teknologjike: Do të punohet që arsimi duhet të zbatojë teknologjitë moderne digjitale arsimore në mësimdhënie dhe mësimnxënie për të pasur rezultate të mira. Do të punohet në digjitalizimin e shkollës dhe furnizimi me teknologji arsimore. Do të sigurohen kabinetet e nevojshme për punë aplikative duke integruar librin dhe punën laboratorike e praktike. Do të zbatohet një qasje gjithëpërfshirëse në mësimdhënie, duke zbatuar pako teknologjike për punë të pavarur të nxënësve, duke nxitur kreativitetin dhe forma të tjera. Në procesin mësimor do të zbatohen teknologji, pajisje dhe mjete mësimore të cilat në masë të madhe e lehtësojnë procesin mësimor, sigurojnë të nxënë të qëndrueshëm dhe ndihmojnë në përdorimin e dobishëm të teknologjive të reja nga fëmijët, siç janë mjetet për krijimin e hapësirave mësimore, resurset online, tekste digjitale shkollore, tabela interaktive, sistem të të nxënës dhe mjedise virtuale të të nxënës. Do të sigurohet interneti funksional për të gjitha shkollat, pastaj digjitalizimi i proceseve pedagogjike dhe i komunikimit në procesin arsimor, sigurimi i një laptopi dhe një projektori për klasë, krijimi i klubeve teknike në të gjitha shkollat etj.

8.7. Arsimi profesional

Shkollat profesionale të mesme të larta do të ringjallen e modernizohen me mjete konkretizuese, kurrikula e tekste mësimore adekuate bazuar në një rishikim të standardeve të profesioneve për të reflektuar nevojat e tregut të punës. Do të rishikohet rrjeti dhe profili i këtyre shkollave, bazuar në një strategji zhvillimore që merr parasysh kërkesat e tregut të punës në Kosovës dhe më gjerë. Do të zhvillohet programet e praktikës për të gjithë nxënësit e këtyre shkollave në bashkëpunim me ndërmarrjet në kuadër të arsimit dual në shkollë dhe në punë. Do të fuqizohen qendrat e kompetencës me laboratorë adekuatë, të pajisur me materialet e nevojshme shpenzuese për punë laboratorike të rregullt. Do të zhvillohen qendrat start-up në kuadër të shkollës. Do të konsiderohet themelimi i shkollave digjitale në të gjithë vendin. Do të ndërmerren masa për avancimin e arsimit dhe aftësimin profesional për të rritur punësueshmërinë e të rinjve. Do të bashkëpunohet me odat rajonale ekonomike dhe zejtare, si dhe me shoqatat profesionale që ofrojnë profile e shkathtësi ekskluzivisht për nevoja të ndërmarrjeve në rajonet përkatëse. Do të hartohen programe me qasje fleksibile në reagim ndaj kërkesave të ndërmarrjeve. Do të

funksionalizohet sistemi i këshillimit në karrierë që të bëhet identifikimi i hershëm i prirjeve të nxënësve dhe sigurimi i përkrahjes për realizimin e këtyre prirjeve.

8.8. Arsimi i lartë

Ndryshimet ligjore dhe institucionale: do të rishikohet ligji për arsimin e lartë, për të adresuar nevojat që ka ky nivel i arsimit për zhvillim të mëtejshëm, pavarësi më të madhe, sigurim të burimeve të qëndrueshme të financimit dhe integrim më të madh me ekonominë dhe me arsimin e lartë në BE dhe më gjerë. Ndryshimet ligjore duhet pastaj të përcillen me ndryshime të rregulloreve përkatëse për të mundësuar zbatim adekuat të ligjit të ri. Do të investohet në sigurimin e pavarësisë së plotë të mekanizmave të kontrollit të cilësisë dhe akreditimit. Në të njëjtën kohë, do të mbështeten institucionet e arsimit të lartë, për të plotësuar kërkesat e nevojshme për akreditim. Do të krijohen mekanizma ligjorë për departizimin e menaxhmentit të institucioneve të arsimit të lartë.

Fondi i përsosmërisë: do të krijohet fondi i përsosmërisë, i cili do të ndahet për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve arsimore dhe për programe në funksion të zhvillimit të shoqërisë. Fondi do t'u ndahet individëve, institucioneve e programeve që kanë ide të cilësisë evropiane, por u mungon përkrahja. Një pjesë e fondeve ndahet për projekte cilësore në kuadër të studimeve të doktoratave. Gjatë vitit të parë të ndarjes së këtij fondi do të ndërtohen kapacitetet për absorbimin e mjeteve të fondit, përfshirë hartimin e procedurave e kriterëve, informimin dhe aftësimin e institucioneve, vlerësimin e gatishmërisë së tyre dhe certifikimin e institucioneve të para. Kriteret për ndarjen e këtyre mjeteve do të bazohen në rezultatet në skemat e rangimit të institucioneve të arsimit të lartë, vlerësimet nga Agjencia e Akreditimit, pjesëmarrjen në programet Erasmus, numrin e mobiliteteve, funksionalitetin e menaxhmentit, kapacitetin për menaxhim të programeve dhe kriteret të tjera.

Profilizimi i universiteteve të reja publike: Universitetet e reja nuk kanë kapacitete për misionet e tyre, organizojnë kryesisht programe të cilat ofrohen edhe nga Universiteti i Prishtinës dhe nuk u përshtaten specifikave të regjionit ku ato funksionojnë. Prandaj, do të ndërmerren veprime për të ndihmuar këto institucione që të profilizohen në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe nevojën për të diversifikuar arsimin e lartë. Universitetet e reja publike do të hyjnë në procesin e profilizimit në përputhje me parimet e Ligjit, Procesin e Bolonjës dhe kriterëve të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë. Profilizimi do të bëhet në bazë të një studimi gjithëpërfshirës, i cili përfshin të gjithë akterët relevantë si profesorët, studentët, industrinë, shoqërinë civile, institucionet shtetërore, komunitetin etj. Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj do të mbështetet me fonde që të inkurajohet në ofrimin e programeve profesionale si i vetmi institucion publik në Kosovë me mision për shkenca të aplikuara. Universiteti i Mitrovicës do të përkrahët për funksionim të plotë, si universitet me profil të qartë, që u shërben nevojave të Kosovës dhe të rajonit të Ballkanit Perëndimor në fushën e makinerisë prodhuese, xehetarisë dhe metalurgjisë.

Rangimi i institucioneve të arsimit të lartë: rangimi do të bazohet në disa kriteret, si: proporcioni student-mësimdhënës, numri i orëve të kontaktit me studentë, investimet vjetore në infrastrukturë për studentë, shkalla e punësimit të të diplomuarve, cilësia e punëve që fitojnë të diplomuarit, pritja për punësim, cilësia e infrastrukturës, hapësira në

dispozicion, shërbimet për përkrahjen akademike të studentëve, përkrahja e studentëve me nevoja të veçanta, kriteret e pranimit, numri i studentëve aplikues dhe i atyre të regjistruar sipas programeve, përkrahja për zhvillimin e personelit, numri i publikimeve të personelit, numri i publikimeve/njësisve librare nga institucioni e të tjera.

Sistemi i integruar i informimit: kjo masë do të sigurojë vendimmarrje, bazuar vetëm në të dhëna të krahasueshme me vendet e tjera. Në këtë drejtim, do të sistematizohen të dhënat për librin amzë në ministri, databazat e institucioneve arsimore që duhet të jenë kompatible me kërkesat e Agjencisë së Akreditimit dhe standardeve të vendosura në arsimin e lartë/ Të gjitha databazat do të integrohen për të prodhuar tregues të nevojshëm për menaxhim efikas të institucioneve të arsimit të lartë.

Fuqizimi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim: do të fuqizohet baza ligjore për funksionim të pavarur të Agjencisë, duke e mbështetur edhe me resurset e nevojshme për të kryer punën e saj sipas standardeve evropiane të arsimit të lartë, përfshirë këtu edhe funksionalizimin e mekanizmit të ankesave bazuar në rregulloret përkatëse. Në këtë drejtim, do të nxirret ligji i veçantë për Agjencinë, i cili siguron pavarësinë e këtij institucioni, transparencën në vendimmarrje, mënyrën e funksionimit etj.

Financimi i arsimit të lartë: do të krijohet baza e qartë ligjore dhe kriteret konkurruese për financim të arsimit të lartë. Do të mobilizohet ekspertiza më e mirë në Kosovë dhe jashtë vendit, në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë, për të hartuar një formulë të financimit të arsimit të lartë që merr para sysh nevojat zhvillimore kombëtare, kahet e zhvillimit institucional (planet strategjike), veçoritë e programeve dhe institucioneve të ndryshme, kërkimet shkencore, sigurimin e cilësisë dhe zhvillimin infrastrukturor e teknologjik të institucioneve të arsimit të lartë.

Mbështetja e shkencës në arsimin e lartë: të gjitha institucionet e arsimit të lartë do të mbështeten për të ndërmarrë aktivitete shkencore si pjesë e avancimit dhe sigurimit të cilësisë në mësimdhënie. Do të inkurajohen institucionet dhe stafi mësimdhënës për angazhim në aktivitete shkencore përmes mbështetjes së publikimeve, hulumtimeve të ndryshme aplikative, duke nxitur bashkëpunime ndërkombëtare etj.

8.9. Gjithëpërfshirja dhe barazia në arsim

Qasja në arsim, e bazuar në të drejtat e njeriut, duhet të jetë bazament në secilin aspekt të arsimit. Nxënësit dhe studentët me nevoja të veçanta, grupet e pafavorizuara, komunitetet shumicë, femrat, fëmijët dhe pjesëtarët e grupeve që janë dëmtuar nga lufta, nxënësit dhe të rinjtë në gjendje të vështirë ekonomike e sociale dhe grupe të tjera të ngjashme duhet të ndihmohen për të krijuar një mjedis mundësues dhe mobilitet social në shoqërinë kosovare. Për këtë qëllim do të hartohen udhëzues për integrimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut për shkollimin e rregullt në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë. Do të përtërihet programi i shkollave mike të nxënësve, si dhe projekte individuale nga shkollat dhe institucionet e arsimit të lartë të cilat kanë për qëllim të promovojnë dhe të zbatojnë qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut në të gjitha nivelet e arsimit. Projektet do të përfshijnë bursa për nxënës e studentë, ndihmë me pajisje mësimore, rrjetëzim të shkollave dhe organizatave të ndryshme aktive në këtë fushë, masa për ndihmë ekonomike familjeve,

ndihmë në rroba, përkrahje në kryerjen e detyrave të shtëpisë, përkrahje në mësim e të tjera.

8.10. Arsimi për komunitetet jo shumicë

Institucionet arsimore do të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të siguruar gjithë përfshirje në arsim për komunitete joshumicë. Do të punohet nga afër me të gjitha komunitetet për integrimin e tyre në sistemin arsimor të rregullt, përfshirë masat për parandalim të braktisjes së arsimit. Në kuadër të sistemit të bursave për studentë në arsimin e lartë, do të ketë një skemë të veçantë për mbështetje të studentëve nga komunitetet jo shumicë. Në kuadër të Ministrisë do të themelohet sektori për arsim të komuniteteve joshumicë, ku do të angazhohen zyrtarë përgjegjës për arsim për secilin komunitet joshumicë. Së bashku me institucionet përkatëse, do të punohet në përgatitjen e teksteve mësimore përkatëse për arsim në gjuhën e komuniteteve joshumicë. Në kuadër të arsimit në diasporë, do të ofrohet mbështetje edhe për ofrimin e arsimit në gjuhën e komuniteteve jo shumicë në shtetet ku janë të vendosur pjesëtarët e këtyre komuniteteve. Do të punohet në përgatitjen e mësimit për të ofruar arsim në gjuhët e komuniteteve joshumicë. Përfaqësues të komuniteteve jo shumicë do të jenë pjesë e trupave institucionale, agjencive dhe këshillave të ndryshme arsimore dhe shkencore. Në institucionet e arsimit të lartë do të punohet në hapjen e drejtimeve në gjuhët e komuniteteve jo shumicë në përputhje me nevojat dhe përgatitjet e atyre institucioneve arsimore.

8.11. Shkenca

Do të rithemelohet Këshilli Kombëtar i Shkencës dhe do të përgatitet Programi Kombëtar i Shkencës. Do të mbështetet ngritja e kapaciteteve të instituteve shkencore në kuadër të institucioneve të arsimit të lartë ose jashtë tyre. Do të mbështetet zhvillimi i studimeve të doktoratës bazuar në projekte. Universitetet do t'i fuqizojmë duke i mbështetur në kërkime shkencore të kuadrove specifike. Mbështetja për shkencë do të kanalizohet përmes Fondit Formues dhe Fondit të Ekselencës. Fondi Formues do të shërbejë për ngritjen e kapaciteteve dhe do të ofrojë përkrahje për konkurrim. Ndërkaq, Fondi i Ekselencës do të mbështesë projekte cilësore për programe evropiane dhe projekte cilësore për studime të doktoratës dhe studime master, si dhe hulumtime në fushën e aplikimit të teknologjive të reja. Bazuar në parime të njëjta, do të ndahen mjete nga këto dy fonde edhe për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Institutit Albanologjik, Instituteve në kuadër të universiteteve dhe institucioneve arsimore.

8.12. Koordinimi i donatorëve

Do të ndërtohen kapacitetet për shpenzimin e fondeve zhvillimore ndërkombëtare në fushën e arsimit dhe shkencës. Do të krijohen mekanizma që të krijohen fonde të përbashkëta, që menaxhohen bashkërisht bazuar në strategji të qartë të përdorimit të tyre dhe planin kombëtar për zhvillimin e arsimit. Asistenca teknike ndërkombëtare do të kanalizohet maksimalisht përmes ministrisë dhe trupave mbështetëse. Do të fuqizohet njësia për koordinimin e projekteve, e cila përkrahë ministrinë dhe donatorët për implementimin e strategjive dhe përdorimin efikas të fondeve ndërkombëtare. Në njësinë për koordinim të projekteve do të vendosen edhe ekspertët ndërkombëtar të prokurimit e

të financave për të kontrolluar shpenzimin e mjeteve, duke koordinuar shpenzimet e këtyre fondeve me donatorët dhe duke siguruar rregullsinë e përdorimit të tyre.

9. SHËNDETËSIA

9.1. Prioritetet në shëndetësi dhe reformat kryesore

Menaxhimi i pandemisë nga COVID-19 do të jetë prioritet, por krahas kësaj do të zhvillohet sistemi shëndetësor për të siguruar shërbime cilësore për qytetarë. Qasja reformative në shëndetësi bazohet në moton “Politikat shëndetësore në të gjitha politikat”, me synim të sigurimit të një qasje universale në shërbime shëndetësore. Synohet të ndërtohet një sistem shëndetësor efikas, i mbështetur në resurse të qëndrueshme njerëzore dhe me një financim të qëndrueshëm, që siguron qasje të barabartë në shërbime cilësore dhe kosto efektive shëndetësore për të gjithë qytetarët. Që të arrihet kjo, reforma e sistemit shëndetësor do të ketë në qendër ngritjen e efikasitetit të institucioneve shëndetësore në të gjitha nivelet, përmirësimin e infrastrukturës dhe mjeteve të funksionimit, funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore, shfrytëzimit optimal të resurseve profesionale, integrimin më të mirë të shërbimeve shëndetësore në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor, si dhe zhvillimin e kapaciteteve menaxheriale në kuptim të rritjes së përgjegjësisë dhe të transparencës.

Bazë e programit do të jetë zhvillimi i të gjitha niveleve të sistemit shëndetësor, si pjesë të një tërësie, të cilat e ndihmojnë njëra-tjetrën dhe e kompletojnë shërbimin shëndetësor. Në orientimet programore të të gjitha niveleve shëndetësore, qytetari do të jetë në qendër. Qeveria do të kanalizojë më shumë fonde për zonat ku mungojnë shërbimet shëndetësore adekuate dhe të mundësojë subvencione për personelin mjekësor të kualifikuar që të shërbejë në zona të tilla. Vëmendje e veçantë do t’u kushtohet kategorive vulnerabile të shoqërisë, siç janë: fëmijët, të moshuarit, të sëmurët nga kanceri, kategoritë në gjendje të rëndë sociale, pjesëtarëve të disa prej komuniteteve jo shumicë më në nevojë.

9.2. Roli i Ministrisë së Shëndetësisë

Sistemi i ri shëndetësor i vendit do të mbështetet në Ministrinë e riorganizuar të Shëndetësisë, të fuqizuar në rolin e saj politikbërës, rregullator, vlerësues dhe monitorues, si dhe funksionalizimin dhe forcimin e plotë të institucioneve të reja, siç janë: Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore dhe SHSKUK-ja, si formë e integruar e shërbimeve në nivelin dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor.

9.3. Financimi i shëndetësisë

Duke pasur parasysh faktin se resurset financiare në dispozicion për shërbimet shëndetësore publike nuk plotësojnë nevojat dhe kërkesat e popullatës për shërbime cilësore shëndetësore, Qeveria do të realizojë reformën e financimit të sektorit të shëndetësisë. Qeveria do të themelojë modelin miks të financimit, nga Buxheti i Kosovës dhe nga Fondi Publik i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor për të gjithë qytetarët dhe banorët e vendit, në pajtim me Ligjin për Sigurime Shëndetësore dhe me mbështetjen e Donatorëve.

9.4. Menaxhimi dhe llogaridhënia

Qeveria do të angazhohet për një menaxhim të integruar të shëndetësisë në të gjitha nivelet, me sisteme të qarta dhe efikase të referimit. Gjithashtu, do të angazhohet për shpërndarje adekuate të infrastrukturës dhe të kuadrit mjekësor në të gjithë territorin e vendit, arritje të standardeve ndërkombëtare sa i përket numrit të personelit mjekësor në raport me popullsinë, decentralizim dhe autonomi menaxheriale të institucioneve shëndetësore. Menaxhimi i përmirësuar me resurset njerëzore do të realizohet nëpërmjet Odave të Profesionistëve Shëndetësorë, si organe kredibile përfaqësuese të mjekëve, stomatologëve, farmacistëve, infermierëve, dhe fizioterapeutëve. Ministria e Shëndetësisë do të monitorojë për së afërmi periudhën e bartjes së kompetencave përkatëse, në përputhje me ligjin. Në funksion të eliminimit të dukurive negative brenda sektorit të shëndetësisë do të fuqizohet komunikimi i drejtpërdrejtë dhe sistematik i Ministrisë së Shëndetësisë me qytetarët dhe shoqatat e pacientëve nëpërmjet linjave të drejtpërdrejta telefonike, si dhe ndërmarrjen e të gjitha veprimeve adekuate që shkojnë në funksion të ngritjes së përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

9.5. Shëndeti publik dhe parandalimi i sëmundjeve ngjitëse

Qeveria do të angazhohet për ndërtimin e institucioneve kompetente të shëndetësisë publike, të cilat me profesionalizëm dhe qasje multidisiplinare do të angazhohen për ruajtjen e shëndetit publik, parandalimin dhe sanimin e vatrave endemike të sëmundjeve ngjitëse, kontrollin e rregullt të ujit, ajrit, ushqimit dhe parametrave të tjerë të shëndetit publik.

9.6. Edukimi dhe shkollimi specialistik dhe subspecialistik

Qeveria është e ndërgjegjshme që shkenca e mjekësisë është një ndër shkencat që evoluon me një dinamikë të shpejtë, prandaj është domosdoshmëri investimi në kualifikimin dhe përditësimin e burimeve njerëzore me njohuri dhe praktika të reja. Në këtë prizëm, kujdes i veçantë do t'i kushtohet programit shtetëror të shkollimit specialistik dhe subspecialistik të kuadrove profesionale jashtë vendit, në institucione të mirënjohura shëndetësore të rangut ndërkombëtar. Për këtë qëllim, do të krijohet edhe një fond i veçantë i bursave për studime në fushën e mjekësisë në universitete perëndimore, si dhe mbështetje të projekteve të hulumtimeve shkencore. Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve profesionale, Qeveria do të krijojë kushte optimale për profesionistët e shumë shëndetësorë me origjinë nga Kosova, tanimë të afirmuar në vendet e zhvilluara të Evropës dhe Amerikës, që me ekspertizën dhe projektet e tyre të kontribuojnë për reformimin dhe zhvillimin e shëndetësisë në Kosovë.

9.7. Edukimi publik shëndetësor

Duke pasur parasysh që përgjegjësia kryesore për të qëndruar të shëndetshëm i takon vetë qytetarëve, qeveria më shumë vëmendje dhe duke venë në dispozicion burime të shumta, do t'i kushtojë parandalimit të sëmundjeve të ndryshme dhe edukimit të publikut. Një qasje e tillë do të ndërmerret në bashkëpunim me organizatat joqeveritare që realizojnë aktivitete në lëmin e shëndetësisë. Për këtë synim, do të hartohen politika që mundësojnë pajisjen e publikut me më shumë informacion për t'i inkurajuar dhe edukuar për një jetë të

shëndetshme si masë parandaluese dhe inkurajim i përdorimit të terapive rigjeneruese, nëse janë të sëmurë kronikë ose persona në risk.

9.8. Sektori farmaceutik

Në sektorin farmaceutik parashihen reforma përmbajtjesore me ngritjen e kapaciteteve politikëbërëse, rregullatore, vlerësuese, dhe inspektuese të Agjencisë së Kosovës për Produkte Medicinale. Do të ndërmerren masa lidhur me Listën Esenciale të Barnave dhe Materialit Medicinal, duke përpiluar një listë esenciale e cila nuk do të jetë statike, por do të ketë të inkuorporuar një mekanizëm për hyrje-daljen e produkteve nga lista esenciale. Do të krijohen hapësira të veçanta për deponimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e produkteve dhe materialit medicinal në Barnatoren Qendrore të QKUK-së, por edhe në barnatoret e Spitaleve të Përgjithshme të shërbimit sekondar. Do të zhvillohen politika të reja për prokurimin e barnave të bazuara në vlerësimin real të nevojave dhe planifikimin adekuat dhe me kohë decentralizimin e furnizimit me barna nga Ministria e Shëndetësisë në vetë institucionet shëndetësore me një qasje llogaridhënëse nga ana e institucioneve shëndetësore. Po ashtu, do të bëhet riorganizimi i menaxhmentit farmaceutik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike për ruajtjen e shëndetit publik, Qeveria do të monitorojë qarkullimin e barnave dhe produkteve medicinale në tregun e Kosovës, në pajtim me standardet më të larta të Bashkësisë Evropiane.

9.9. Licencimi dhe Akreditimi i institucioneve shëndetësore

Në pajtim me Ligjin për Shëndetësi dhe duke pasur parasysh nevojën e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore, Qeveria do të punojë në krijimin e ambientit të favorshëm për Licencimit dhe Akreditimit të shërbimeve shëndetësore sipas standardeve ndërkombëtare.

9.10. Zhvillimi i partneritetit dhe dialogu social

Vëmendje të veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të partneritetit dhe dialogut social me Federatën e Sindikatave Shëndetësore të Kosovës, me theks të veçantë në respektimit të drejtave të punëtorëve shëndetësorë dhe të drejtave të pacientëve. Po ashtu, do të fuqizohet bashkëpunimi me organizatat në sektorin joqeveritar, në vend dhe jashtë, veçanërisht me shoqatat të cilat përfaqësojnë interesat e pacientëve, si mënyrë për ofrimin e shërbimeve më cilësore dhe shërbimeve të veçanta për grupet vulnerable të qytetarëve në mënyrën më kosto efektive, me theks të veçantë promovimin e mënyrave të shëndosha të jetesës si forma më efektive për parandalimin e sëmundjeve. Qeveria në mënyrë të vazhdueshme do të angazhohet të përmbushë obligimet që dalin nga Strategjia Kombëtare për persona me nevoja të veçanta, si dhe do të ndërmarrë aktivitete të veçanta për sigurimin e shërbimeve cilësore shëndetësore dhe me qasje të lehtë për grupet e popullsisë dhe komunitetet më në nevojë. Përkushtim i veçantë do të kenë aktivitetet për integrimin e plotë në sistemin shëndetësor të vendit të shërbimeve shëndetësore në komunat me shumicë të komunitetit serb.

9.11. Sektori privat shëndetësor

Sektori publik dhe ai privat në shëndetësi nuk duhet të shihen si përjashtues/zëvendësues të njëri-tjetrit, por si dy sisteme që e komplementojnë njëra-tjetrën. Institucionet shëndetësore private do të kenë trajtim të barabartë konkurrues dhe komplementar në sistemin shëndetësor në të mirë të qytetarit. Qeveria do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për t'u siguruar se institucionet shëndetësore private zbatojnë me përpikëri gjithë legjislacionin e vendit që rregullon këtë sektor në funksion të ofrimit të shërbimeve shëndetësore kualitative.

9.12. Përgjegjësitë dhe integrimi i tri niveleve të kujdesit shëndetësor

Niveli primar shëndetësor (niveli komunal): Në nivelin primar shëndetësor, do të avancohet koncepti i mjekësisë familjare. Do të ofrohen specialistët e nevojshëm në këtë nivel të kujdesit shëndetësor për secilën komunë, duke stimuluar mjekët sipas nevojës nga ana e komunave. Do të standardizohet pakoja e shërbimeve shëndetësore primare në të gjitha komunat. Do të fuqizohen kapacitete diagnostikuese, me theks të veçantë në lëmin e radiologjisë dhe të laboratorit. Do të fuqizohet shërbimet emergjente para spitalore. Do të mbështeten komunat për të themeluar dhe fuqizuar shërbimin shtëpiak shëndetësor paliativ për grupet vulnerabile (personat me nevoja të veçanta, pacientët me sëmundje të rënda kronike, ata me sëmundje malinje, si dhe të moshuarit). Do të rishikohen rregulloret e punës së departamenteve të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale për të qenë në funksion të ofrimit të këtyre shërbimeve. Do të vendosen mekanizma të monitorimit të punës së stafit shëndetësor, përfshirë vlerësimin e rregullt të punës së tyre. Do të përmirësohet infrastruktura në shëndetësinë primare për qasje të lehtë për personat me nevoja të veçanta. Do të hartohen master-plane për komuna dhe shpërndarje e pacientëve sipas qendrave të mjekësisë familjare korrespondente. Do të funksionalizohen kartelat shëndetësore dhe digjitalizohen ato. Do të standardizohen protokollat shëndetësore në shëndetësinë primare dhe format e referimeve në nivele më të larta të kujdesit shëndetësor. Do të fuqizohen shërbimet për shëndetin e nënës dhe fëmijës përmes funksionalizimit të shërbimeve të rregullta shtëpiake, përfshirë përcjelljen para shtatzënisë, gjatë shtatzënisë, pas lindjes, si dhe përcjellja e zhvillimit të fëmijës nga 0-6 vjet. Do të ofrohet kujdes i plotë ndaj fëmijëve parashkollorë dhe atyre shkollorë. Do të funksionalizohet pakoja e shërbimeve për menaxhimin e sëmundjeve kronike bazuar në pakon esenciale të OBSH për menaxhimin e sëmundjeve kronike.

Niveli sekondar shëndetësor (spitalet rajonale): Ky nivel do të integrohet më mirë me nivelin primar shëndetësor dhe nivelin terciar. Do të themelohet Spitali i Prishtinës si një nga prioritetet kryesore. Do të funksionalizohet Spitali i Podujevës. Do të decentralizohet vendimmarrja dhe rritet autonomia menaxheriale e këtyre institucioneve shëndetësore brenda sistemit të integruar të shërbimit spitalor. Do të mbështeten këto institucione në zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve dhe resurseve profesionale. Do të fuqizohen kapacitetet diagnostike. Do të standardizohen dhe racionalizohen procedurat e shfrytëzimit të pajisjeve mjekësore. Do të zhvillohet dhe implementohen protokolle standarde/unike lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore unë të gjitha spitalet e nivelit dytësor. Aty ku ka kapacitete, do të fuqizohet ofrimi i shërbimeve të specializuara.

Niveli terciar shëndetësor: është më se e nevojshme të ndërmerret riorganizimi i QKUK-së, përfshirë edhe mundësinë e themelimit të Qendrave tjera Spitalore si Instituti për Nënë dhe Fëmijën, Institutit për sëmundje kardiovaskulare dhe Spitalit të Prishtinës brenda QKUK-së. Kjo për arsye, sepse QKUK-ja, përveç shërbimeve shëndetësore, ofron edhe shërbime edukative, hulumtuese dhe shkencore. Është e nevojshme që i gjithë personeli shëndetësor të përfshihet në procesin mësimor edukativ me titull akademik klinik apo shkencor. Do të punohet për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe furnizimin me pajisje mjekësore, si dhe mirëmbajtjen dhe servisimin e tyre në përputhje me standardet evropiane. Nevojë imediate është zhvillimi i kapaciteteve menaxheriale në kuptim të rritjes së përgjegjësisë, transparencës dhe llogaridhënies së strukturave menaxheriale. Në këtë drejtim, duhet të punohet në drejtim të organizimit të një qendre moderne terciare, me një strukturë organizative, profesionale shkencore të veçantë. Do të rishikohet bashkëpunimi me Fakultetin e Mjekësisë për të siguruar një bashkëpunim më të ngushtë dhe më funksional e më të integruar për të siguruar edukim të profileve mjekësore për plotësimin e nevojave të të gjithë sistemit shëndetësor të Kosovës, si dhe të trendeve ndërkombëtare në fushën e edukimit mjekësor dhe të mbrojtjes shëndetësore të popullatës. Do të mbështetet ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve hulumtuese dhe shkencore, si dhe edukimi i vazhduar profesional i stafit mjekësor. Do të mbështeten institucionet terciare shëndetësore në krijimin e qendrave edukative arsimore që do të jenë promotorë në ruajtjen e shëndetit të popullatës së Kosovës.

9.13. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Përveç sigurimit të koordinimit të plotë me komunitetin e donatorëve në sektorin e shëndetësisë të vendit, Qeveria do të angazhohet për bashkëpunim dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare shëndetësore, pastaj Rrjetin Shëndetësor të Evropës Juglindore, si dhe pjesëmarrjen aktive në bashkëpunime bilaterale dhe multilaterale në fushën e shëndetësisë ndërkombëtare.

10. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

Duke marr parasysh potencialin që ka sektori bujqësor për rritjen e prodhimit vendor dhe punësimin të fuqisë punëtore në gjithë zinxhirin prodhues, përpunues dhe shërbyes, Qeveria do të angazhohet fuqishëm për mbështetjen e sektorit bujqësor, duke filluar nga prodhimtaria, primare, ruajtja, përpunimi dhe tregtimi si produkte finale. Mbështetja për bujqësinë në programin për zhvillimin bujqësor të qëndrueshëm dhe në strategjinë për mbrojtjen e prodhimeve vendore. Mbështetja do të jetë për të gjitha fazat e prodhimit bujqësor, me fokus në sektorët ku vendi ka avantazhe krahasuese. Nisur nga fakti që Kosova ka orientim drejt integritimit në BE, orientimi i qeverisë do të jetë që politikat e zhvillimit të bujqësisë të përafrohen me Politikën e Përbashkëta Bujqësore të BE-së.

Masat për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural në përgjithësi përfshijnë:

- Rritja e investimeve në fermë dhe në sektorët prioritarë,
- Siguria e ushqimit,
- Ujitja e tokave bujqësore,
- Funkcionalizimi i sigurimeve bujqësore,
- Lehtësimi i qasjes në financa për fermerë,
- Zinxhiri i vlerës në prodhimin bujqësorë,
- Përkrahja e aktiviteteve jo bujqësore dhe diversifikimi i zhvillimit rural,
- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore,
- Mbrojtja dhe valorizimi i resurseve pyjore.

10.1. Rritja e investimeve në fermë dhe në sektorët prioritarë

Për të përmirësuar strukturën e fermës, Qeveria do t'u ofroj fermerëve dhe agrobizneseve mundësi të investimeve përmes skemave të granteve dhe subvencioneve. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet rritjes së fondit për subvencione dhe grante për kulturat me potencial për eksport. Gjithashtu, do të krijohen mekanizma që mundësojnë ndryshimin e formës së përkrahjes duke e orientuar mbështetjen nga prodhimi.

Duke qenë se Kosova ka përparësi krahasuese në kultivimin e pemëve e imta (mjedra, boronica, dredhëza, manaferra, aronia, etj.), bimëve mjekuese aromatike, rrushit dhe verërave dhe perimeve, në programin për mbështetje të bujqësisë do të parashihet përkrahje e veçantë për këto kultura. Do të lëvizet drejt subvencionimit të rendimentit për kg për pemët e imëta dhe sektorëve të tjerë me prioritet. Prodhuesit bujqësorë do të subvencionohen për certifikim për kultura të caktuara bujqësore lidhur me standardet e sigurisë së ushqimit. Kjo masë ka për qëllim të rrisë kualitetin, sigurinë dhe vlerën e produkteve bujqësore të prodhuara në vend.

Do të konsiderohet subvencionimi i akcizës për naftë për aktivitete bujqësore që do të ndikojë në uljen e çmimit të naftës për fermerë së paku për 30-35%, masë e cila do të ndikojë në uljen e kostos së prodhimit bujqësorë. Do të përkrahen shoqatat e prodhuesve dhe përpunuesve që të kenë mundësi të përfaqësojnë interesat e prodhuesve bujqësor në nivelet qendrore dhe lokale të vendit. Do të krijohet fondi i veçantë i granteve për të rinjtë në bujqësi për të mbështetur ndërmarrësit e rinj në bujqësi që sjellin ide inovative në prodhimin dhe përpunimin bujqësor.

Mbështetja me grante dhe subvencione për bujqësi do të ndërlidhet edhe me masat për promovim të punësimit, në veçanti të grupeve më të marginalizuara të shoqërisë. Mbështetje në këtë drejtim do të marrin në veçanti ato familje nga komunitetet joshumicë që janë më në nevojë.

10.2. Siguria e ushqimit

Me prioritet të lartë do të fuqizohet një sistem funksional i sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit në përputhje me standardet e BE-së. Për këtë qëllim do të zbatohen masa të përshtatshme të bazuara në konceptin “Prej fermës në tryezë”, duke siguruar funksionimin efektiv dhe të sigurt të zinxhirit të prodhimit dhe tregtimit. Gjithashtu, do të krijohen kushte që garantojnë një konkurrence të ndershme në treg të operatoreve ekonomik ushqimor. Në këtë aspekt, do të ndërmerren këto masa:

- Funksionalizimi i laboratorëve për kryerjen e analizave për mbikëqyrjen e sigurisë ushqimore;
- Kontrollimi dhe testimi i vazhdueshëm i ushqimeve që tregtohen për konsum njerëzor, si dhe të ushqimeve që përdoren për kafshë;
- Kontrollimi dhe testimi i vazhdueshëm i përmbajtjes dhe cilësisë së inputeve bujqësore (farërave, plehrave dhe pesticideve) që prodhohen apo importohen;
- Transferimi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë;
- Koordinimi dhe harmonizimi i legjisllacionit vendor me atë të BE-së në fushën e sigurisë ushqimore.

10.3. Ujitja e tokave bujqësore

Për të mbështetur prodhimin bujqësor, do të investohet intensivisht në sistemet e ujitjes së tokave bujqësore, pasi momentalisht vetëm rreth 20 mijë hektarë të tokës bujqësore janë nën ujitje, apo rreth 4.8% të sipërfaqes totale të shfrytëzuar për bujqësi. Këto investime do të rrisin dukshëm rendimentin bujqësor. Duke përdorur të dhënat e regjistrimit të tokave bujqësore, do të mundësohet planifikim i saktë i shtrirjes së rrjetit të ujitjes dhe përdorimin e tij në formë sa më eficiente.

Në këtë drejtim, do të punohet në funksionalizimin (rehabilitimin) e kanaleve ekzistuese të ujitjes dhe në zgjerimin e dy sistemeve kryesore të ujitjes: Ibër-Lepencit për mbulimin me sistem të ujitjes të fushave në Rrafshin e Kosovës, dhe Radoniqit për mbulimin me sistem të ujitjes të fushave në Rrafshin e Dukagjinit. Po ashtu, parashihet projektimi dhe ndërtimi i sistemeve të reja të ujitjes, duke shfrytëzuar edhe një pjesë të madhe të lumenjve, siç janë: Drini, Lepenci, Ereniku, Lumbardhi, Sitnica, Drenica, Llapi e Morava. Përveç investimeve në rrjet të ujitjes, parashihen investime edhe në akumulime të reja të ujit, të cilat do të kenë destinim ujitjen e tokave bujqësore, por që mund të konsiderohen edhe për shfrytëzim për ujë të pijshëm bazuar në standardet e kërkuara për këtë qëllim.

10.4. Funksionalizimi i sigurimeve bujqësore

Do të ndërmerren masa që sa më parë të funksionalizohen sigurimet bujqësore për të evituar, për aq sa është e mundur, humbjet e papritura të fermerëve. Zhvillimi i një sistemi të sigurimit të qëndrueshëm dhe efikas do të kontribuojë në zhvillimin e bujqësisë duke lehtësuar rreziqet dhe duke siguruar investime të mëtejshme në ferma. Ky instrument financiar mund të rrisë besimin për t'i dhënë hua fermerëve dhe do të kontribuojë në rritjen e financimit të sektorit të bujqësisë në përgjithësi.

Funksionimi sistemit të sigurimeve bujqësore do të menaxhohet nga ministria. Për këtë qëllim do të krijohet divizioni për menaxhimin e rrezikut. Do të krijohet fondi për sigurime bujqësore me bashkëfinancim nga qeveria, donatorët dhe pjesëmarrje të bujqve. Fillimisht do të mbulohen disa kultura të caktuara dhe pastaj siguri do të zgjerohet edhe për produkte të tjera, për mbrojtje kundër breshrit, zjarrit, vërshimeve dhe ngjarjeve të tjera të motit. Gradualisht, sigurimet do të zgjerohen edhe në blegtori, ku do të përfshihen lopët, mëshqerrat, delet, dhitë dhe shpezëtaria).

10.5. Lehtësimi i qasjes në financa për fermerë

Sektori i bujqësisë është një nga sektorët me financimin më të ulët nga sektori financiar. Prandaj, me qëllim të rritjes së financimit në bujqësi, fermerët që marrin kredi bujqësore nga bankat do të marrin përsipër riskun e kthimit të kredisë, ndërsa qeveria do të marrë përsipër ta paguajë interesin për atë kredi (plotësisht apo pjesërisht varësisht nga objektivat që përcaktohen në programin e zhvillimit bujqësorë dhe kulturave/produkteve prioritarë në periudha të caktuara kohore)

10.6. Zinxhiri i vlerës në prodhimin bujqësorë

Do të mbështetet i gjithë zinxhiri prodhues bujqësor për të siguruar rritjen e vlerës së prodhimit dhe cilësisë së produkteve bujqësore. Përmes kësaj forme të mbështetjes, do të rritet produktiviteti bujqësorë, siguria ushqimore, cilësia e produkteve, mirëqenia e kafshëve, forcimi i lidhjeve mes akterëve të zinxhirit të vlerës, dhe përfundimisht në rritjen e aftësisë konkurruese të fermerëve.

Momentalisht, një sasi e konsiderueshme e prodhimeve bujqësore në Kosovë shiten si produkte primare, kryesisht produktet e destinuara për eksport. Përveç kësaj, një sasi tjetër shitet nëpërmes tregjeve ilegale, për shkak të mungesës së certifikimit dhe organizimit të mirë të tregut formal. Prandaj, programi për mbështetje të bujqësisë synon që produkteve bujqësore të kultivuara në vend t'ua rrisë vlerën përmes investimeve në zinxhir të vlerës. Masat do të fokusohen në nivel të industrisë përpunuese, duke mbështetur qendrat grumbulluese dhe qendra përpunuese, dhe në nivel të fermës, duke investuar në dhoma të ruajtës së produkteve me pajisje përcjellëse.

Do të investohet në krijimin e infrastrukturës përcjellëse për prodhimin dhe paketimin e produkteve në nivel të fermës duke i mbështetur fermerët me pajisje dhe infrastrukturë përcjellëse për përpunim dhe paketim. Sektorët me prioritet në këtë masë parashihet të jenë blegtoria dhe sektori i pemëve të imëta dhe bimëve mjekuese dhe aromatizuese. Në ëtë mënyrë, fermerët do të kenë mundësi që të përpunojnë produktet e tyre të fermës, që do të ndikojë direkt në rritjen e vlerës së këtyre produkteve, dhe rrjedhimisht, rritjen e të

hyrave në fermë. Po ashtu, do të mbështeten përpunuesit e produkteve bujqësore në rritjen e kapaciteteve përpunuese.

Do të përkrahen drejtpërdrejt fermerët në tregtimin e produkteve bujqësore përmes shërbimeve këshillimore për fermerë për gjetjen e tregjeve për shitjen e produkteve të tyre, fuqizimin dhe respektimin e kontratave me qendrat grumbulluese dhe industrinë përpunuese. Përtej kësaj, do të punohet me komunat në krijimin e tregjeve të fermerëve nëpër komunat e tyre përkatëse me kushte adekuate për tregtim të produkteve bujqësore.

10.7. Përkrahja e aktiviteteve jo bujqësore dhe diversifikimi i zhvillimit rural

Për të mbështetur prodhimin bujqësor dhe promovuar atë, do të ndërmerren masa komplementare që diversifikojnë zhvillimin ekonomik në zonat rurale, siç është turizmi rural, aktivitetet artizanale, bujtinat dhe ushqimet tradicionale në zonat rurale dhe malore etj. Qeveria do të mbështesë intensivisht këto lloje të bizneseve në zonat rurale, në veçanti në zonat ku kushtet natyrore e mundësojnë një gjë të tillë dhe ku mund të ketë kufizime për zhvillimin e bujqësisë prodhuese intensive. Këto biznese do të mbështeten me grante për zhvillim të biznesit bazuar në burimet lokale (duke përdorur prodhimtarinë vendore) me qëllim të krijimit të vendeve të reja të punës dhe zhvillimit të qëndrueshëm të viseve rurale.

10.8. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore

Do të ndërmerren masa për të ndaluar degradimin e tokës bujqësore dhe ndërrimin e destinimit të përdorimit. Në këtë drejtim, do të ndërmerren masa parandaluese, por edhe politika stimuluese për fermerë për shfrytëzimin e tokës bujqësore për prodhimtari bujqësore. Në veçanti do të ndërmerren masa për parandalimin e ndotjes së tokave bujqësore nga ndotës të ndryshëm të ujit (lumenjve të ndotur) apo ajrit. Ruajtja e tokës bujqësore do të përcillet me zbatimin rigoroz të infrastrukturës ligjore dhe masat stimuluese për prodhuesit në mënyrë që ata ta shohin interesin e ruajtjes së sipërfaqeve të punueshme. Sipas nevojës do të ndahen fonde për rregullimin e tokave bujqësore përmes zbatimit të masave meliorative. Duke pasur parasysh madhësinë shumë të vogël të pronave, do të ndërmerren masat e nevojshme për vazhdimin e procesit të komasacionit në konsultim dhe dakordim me fermerët, i cili proces është ndërprere për gati tri dekada.

10.9. Mbrojtja dhe valorizimi i resurseve pyjore

Për qëllime mjedisore, prodhuese dhe qëllime të tjera, prioritet do të jetë mbrojtja nga degradimi i resurseve pyjore dhe pyllëzimi i sipërfaqeve të reja. Kjo masë është e domosdoshme pasi pyjet janë dëmtuar në masë të konsiderueshme nga prerja, erozioni, gurëthyesit etj. Fillimisht të ndalet prerja e paligjshme, duke siguruar koordinim të fuqishëm në mes të nivelit qendror dhe lokal për mbikëqyrje të pyjeve. Pastaj, me programe masive do të intervenohet në pyllëzimin e sipërfaqeve të reja, si një nevojë urgjente. Do të rishikohet legjislacioni ekzistues që do të mundësojë shfrytëzim racional të pyjeve, krahas pyllëzimit të vazhdueshëm të sipërfaqeve të reja.

11. INFRASTRUKTURA, ENERGJIA, MINIERAT, UJËRAT DHE AMBIENTI

11.1. Infrastruktura rrugore dhe hekurudhore

Zhvillimi i infrastrukturës është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Qeveria do të angazhohet për krijimin e një sistemi efikas të transportit. Do të punohet për krijimin një sistemi multimodal të integruar të transportit rrugor, hekurudhor dhe ajror, me çmime të ulëta dhe ambient të sigurt, i cili do t'ua mundësojë qytetarëve të zgjedhin transportin më efikas dhe më të volitshëm për plotësimin e nevojave të tyre. Do të bashkëpunohet ngushtë me vendet fqinje për integrim në rrjete infrastrukturore rajonale dhe ndërkombëtare.

Rrugët e rëndësisë nacionale, përfshirë autostradat që lidhin rajonet e Kosovës dhe ato që sigurojnë qasje në vendet fqinjë, do të trajtohen me prioritet gjatë mandatit qeverisës në përputhje me mundësitë buxhetore dhe duke bërë përpjekje që të gjenden burime jashtëbuxhetore të financimit. Qeveria do të fillojë procedurat për ndërtimin e autostradës së Dukagjinit, vazhdimin e autostradës në drejtim të Podujevës dhe pikës kufitare, ndërtimin e autostradës së Anamoravës, autostradës për Mitrovicë dhe rrugët e tjera të rëndësisë nacionale që sigurojnë lidhje me rrjetin infrastrukturor rajonal dhe ndërkombëtarë. Në parim, investimet në infrastrukturën kryesore në nivel vendi që kanë kosto të lartë do të financohet kryesisht përmes kredive të buta ose përmes partneriteteve publiko-private, e cila formë e investimit të infrastrukturës nuk do ta rrezikojnë buxhetin e shtetit.

Në përputhje me mundësitë financiare, do të investohet në funksionalizimin e sistemit hekurudhor dhe të linjave rrugore kryesore. Së bashku me komunat, do të prioritetizohen projektet infrastrukturore lokale. Të gjitha këto do të reflektohen në buxhetin vjetor dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve, në konsultime të gjëra me të gjitha palët.

Një plan strategjik afatgjatë, do të përcaktojë prioritetet kryesore infrastrukturore, i cili plan merr parasysh mundësitë buxhetore në vitet në vijim, në veçanti për shkak të situatës së krijuar nga rënia ekonomike për shkak të pandemisë nga COVID-19. Në këtë drejtim, me kujdes do të analizohet dhe rishikohet dinamika e projekteve infrastrukturore ekzistuese dhe planet për projektet e reja infrastrukture me kosto të madhe buxhetore. Maksimalisht do të punohet në drejtim të financimit të projekteve të tilla përmes kredive koncesionare. Në lidhje me projektet të nivelit lokal e rajonal, do të punohet në drejtim të ngritjen së nivelit të infrastrukturës në lokalitet ku jetojnë komunitetet jo shumicë për të siguruar kushte më të mira jetese dhe integrim më të madh të atyre komuniteteve në jetën ekonomike në nivel vendi.

11.2. Energjia

Do të punohet për zhvillimin e kapaciteteve rregullatore dhe operacionale për arritjen e cakut prej 25% të pjesëmarrjes së energjisë nga burimet e ripërtërishme në bruto-konsumin final të energjisë në një periudhë afatmesme në pajtim me potencialin që ka Kosova, obligimet që burojnë nga rregullativa e BE-së si dhe karshi zhvillimeve dhe përvojës ndërkombëtare.

Rehabilitimi i TC Kosova B do të bëhet konform studimit të fizibilitetit për rehabilitimin e tij për zgjatjen e operimit dhe për plotësimin e komponentëve ambiental sipas direktivave të BE-së. Dekomisionimi i TC Kosova A, ose pjesëve të saj, do të bëhet pas studimit të alternativave të reja të gjenerimit plotësues, bazuar në kërkesat në tregun e energjisë elektrike dhe pasi të sigurohet furnizimi i qëndrueshëm me energji. Do të rishikohet projekti i TC Kosova e Re për realizimin e tij në afat optimal dhe me kosto të përballueshme. Do të zhvillohet projekte të efikasitetit të energjisë si komponentë esenciale e planifikimit dhe orientimit strategjik për zhvillimit ekonomik të Kosovës. Do të përfundohet studimi i fizibilitetit për mundësinë e Kosovës, për t'u kyçur në rrjetin ndërkombëtar të gazit natyror Projekti i gypit Trans Adriatik (TAP).

Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike do të mundësojë një treg konkurrues, transparent dhe i orientuar drejt konsumatorit. Do të punohet për integrimin në tregun rajonal që mundëson optimalizim të sistemeve Kosovë-Shqipëri, si hap i parë drejt integritit të Kosovës në tregun rajonal të energjisë elektrike.

Do të mbështeten projektet e ngrohjes qendrore për të zbutur kërkesën për energji elektrike gjatë dimrit, duke funksionalizuar furnizimin me energji termike në zonat urbane. Do të sigurohen kapacitete të reja gjeneruese për të zgjeruar edhe furnizimin me energji termike për kryeqytetin dhe qytetet tjera. Gjithashtu, do të vazhdohet me mbështetjen e ndërmarrjeve ekzistuese të ngrohjes në Gjakovë, Mitrovicë dhe Zveçan. Do të shqyrtohen mundësitë për ndërtimin e ngrohtores për Drenas nga Ferronikeli, si dhe ngrohtores në qytetet tjera në Kosovë. Po ashtu, do të hartohet projekti për lidhjen e Obiliqit në sistemin e ngrohjes së Termokosit - Prishtinë.

11.3. Minierat

Do të ndërtohet një strategji gjithëpërfshirëse për zhvillimin e minierave bazuar në mekanizma të tregut dhe partneriteteve. Do të punohet në mihjen e re të linjitetit për të siguruar furnizim të sigurt me linjit të kapaciteteve ekzistuese dhe kapaciteteve të reja gjeneruese. Do të kompletohen analizat e nevojshme për të përmyllur studimin e fizibilitetit, duke përfshirë vlerësimin e aseteve dhe përgjegjësi/detyrimeve të Trepçës, si dhe valorizimin e rezervave minerale përmes ekspertizës vendore dhe ndërkombëtare. Rritja e afarizmit/prodhimit industrial të mëtejshëm të Trepçës do të bëhet duke u mbështetur në alternativën më të arsyeshme ekonomike, teknologjike, sociale dhe mjedisore.

11.4. Resurset ujore

Bazuar në strategjinë për shfrytëzimin dhe mbrojtjen e ujërave, ku do të përcaktohen burimet që do të shfrytëzohen për pije, për industri, për bujqësi dhe për ekonomi. Uji i pijshëm do të jetë prioritet dhe si objektivi do të jetë përfshirja e gjithë popullsisë në furnizimin me ujë të pijshëm. Do të punohet që pjesa lindore dhe qendrore e Kosovës, që ka probleme të theksuara me burimet ujore, të ketë akumulimet ujore që sigurojnë së paku 200 milionë m³ ujë për pije, bujqësi dhe ekonomi. Burimet ujore në pjesën perëndimore dhe në Rrafshin e Dukagjinit, përveç që do të jenë prioritet për ujin e pijshëm, do të shfrytëzohen edhe për ujitjen e tokave bujqësore dhe për energjinë elektrik. Sa i përket

ujërave të ndotura, do të ndërtohen impiantet për Prishtinën, Prizrenin, Gjakovën, Gjilanin, Ferizajn, Mitrovicën dhe qendrat e tjera sipas radhës. Do të mbrohen edhe liqenet akumulues që përdoren për ujë të pijshëm.

Do të zgjerohen sistemet e ujitjes së tokave bujqësore, duke zgjeruar dy sistemet kryesore, Ibër-Lepencit dhe Radoniqit, si dhe projektimi dhe ndërtimi i sistemeve të reja të ujitjes duke shfrytëzuar edhe një pjesë të madhe të lumenjve të Kosovës, siç janë: Drini, Lepenci, Ereniku, Lumbardhi, Sitnica, Drenica, Llapi e Morava.

Do të punohet për rregullimin e lumenjve, duke ndërtuar akumulime që mundësojnë shfrytëzimin më të madh të tyre dhe do t'i parandalojë vërshimet. Këtu përfshihen lumenjtë, si Drini, Sitnica, Morava, Llapi, Lepenci e Lumbardhi, dhe për secilin do të hartohet një plan për shfrytëzimin e ujit dhe për parandalimin e vërshimeve. Bazuar në prioritetet që do dalin nga studimet, do të nisim investimet konkrete. Do të punohet për një plan për evitimin e rreziqeve të popullsisë nga vërshimet në përputhje me standardet adekuate për këtë qëllim, përfshirë këtu menaxhimin e ujërave sipërfaqësore që mundësojnë zvogëlimin e rrezikut nga vërshimet.

11.5. Ambienti

Do të zhvillohet legjislacioni dhe kapacitetet mbikëqyrëse që i përcakton vlerat kufitare për lirim e gazrave, kriteret për mbrojtjen e ujërave, ajrit dhe të tokës nga ndotja dhe përdorimi i teknologjisë, në përputhje me standardet evropiane. Do të përgatitet korniza ligjore që sigurojnë balancën në mes të mbrojtjes të natyrës dhe promovimit të zhvillimit ekonomik, përfshirë rishikimin e disa vendimeve për madhësinë dhe mënyrën e menaxhimit dhe shfrytëzimit të parqeve nacionale.

Do të mbështeten kompanitë e menaxhimit të mbeturinave për modernizim të trajtimit të mbeturinave dhe deponive, përfshirë masat për riciklim të materialeve të riciklueshme (siç janë shishet, plastika etj.). Do të eliminohen depozitë e mbeturinave të çfarëdo lloji që janë afër vendbanimeve.

Do të avancohet menaxhimi i parqeve nacionale, për të siguruar mbrojtje adekuate dhe shfrytëzim për rekreacion. Do të themelohet një mekanizëm institucional që do të ketë rolin e policisë mjedisore. Do të ndërmerren masa për përmbushje të kushteve ambientaliste të të gjitha licencave ekzistuese për hidrocentrale dhe gurëthyes, duke vendosur edhe mekanizma monitorues gjatë funksionimit të tyre.

Do të vendosen standardet për pajisje me pulla mjedisore për të gjitha subjektet që përmes veprimtarisë së tyre ndikojnë në ambient në çfarëdo forme. Do të themelohet eko-fondi për të mbështetur subjektet për përmbushje të standardeve mjedisore. Për të përmirësuar sistemin e adresave në Kosovës, do të investohet në kompletimin e sistemit të adresave në të gjitha komunat.

12. MBROJTJA DHE SIGURIA PUBLIKE

12.1. Forca e Sigurisë së Kosovës

Prioritet kryesor i Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, që nga themelimi mbetet promovimi i qeverisjes së mirë dhe synimi për zbatimin e parimeve të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies, në përputhje me legjislacionin në fuqi, normat dhe praktikat ndërkombëtare.

Koncepti Strategjik i Mbrojtjes në Republikën Kosovës bazohet në vlera dhe parime të Kushtetutës. Ky koncept merr për bazë arkitekturën e Sigurisë dhe ka për qëllim të zhvillojë një forcë profesionale të aftë për të vepruar dhe e ndihmuar nga aleatët e NATO-s, në mënyrë që të sigurojë një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë, dhe t'u përshtatet ndryshimeve në mjedisin modern të sigurisë. Përmes përkrahjes institucionale, promovimit të profesionalizmit dhe mbështetjes financiare dhe logjistike, Qeveria do të punojë për tranzicionin e plotë të FSK-së në ushtri profesionale, përmes zhvillimit dhe modernizimit, në pajtim me Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit dhe sipas standardeve vendore dhe të NATO-s me partnerët e saj, si Forcë ndërvepruese me aftësi dhe kapacitete për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial, për mbështetje ushtarake autoriteteve civile dhe për pjesëmarrje në operacione ndërkombëtare. Synimi është të arrihen objektivat e shpenzimit për mbrojtje në minimum 2% të PBB-së.

Republika e Kosovës do të angazhohet për anëtarësimin në iniciativat rajonale të sigurisë dhe integrim në NATO. Në këtë drejtim, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë do të përshpejtohet qasja e FSK-së në mekanizmat euroatlantikë me qëllim që Kosova të anëtarësohet në NATO.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe partneriteti strategjik me vendet e rajonit për çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë mbetet prioritet i Republikës së Kosovës. Partneriteti strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës është garantues i zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve të FSK-së. Republika e Kosovës do të vazhdojë të forcojë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë me vendet e NATO-s, BE-s dhe më gjerë.

Në përputhje me politikat dhe standardet më të mira të NATO-s dhe të vendeve partnere, do të bëhet vlerësimi dhe analiza për shërbimin e detyrueshëm ushtarak.

Republika e Kosovës i mbron interesat e saj përmes respektimit të vazhdueshëm të të drejtave dhe lirive njerëzore, parimeve demokratike dhe respektimit të së drejtës ndërkombëtare, që mundëson zgjidhjen e konflikteve në mënyrë të qetë, avancimin e paqes dhe stabilitetit si dhe përforcimin e imazhit të Republikës së Kosovës në botën demokratike.

12.2. Forcat e rendit dhe të sigurisë publike

Konsolidimi i kornizës ligjore adekuate, si dhe sundimi i ligjit janë kriteret bazike që duhet plotësuar, për të garantuar nivelin e domosdoshëm të rendit dhe të sigurisë publike. Reforma ligjore duhet të fillojë me evidentimin, sistemimin dhe amendamentimin e legjislacionit në fuqi, me qëllim të unifikimit dhe të harmonizimit të tij me standardet e fundit ndërkombëtare për garantimin e rendit dhe të sigurisë publike. Në këtë drejtim, shumica e ligjeve në fuqi duhet të plotësohen dhe të ndryshohen. Përtej kësaj, do të plotësohet korniza ligjore së siguron pensionimin e parakohshëm të policisë, ligji kundër krimit të organizuar, ligji për vetëgjykim, korniza ligjore për sigurimin e shëndetit dhe jetës së pjesëtarëve të organeve të rendit etj.

Koordinimi dhe bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet institucioneve kompetente është kusht për garantimin e rendit dhe të sigurisë publike. Për të mundësuar dhe lehtësuar këtë bashkëpunim, reforma institucionale do të fokusohet në krijimin e platformave të nevojshme për komunikimin ditor, veçanërisht ndërmjet Gjykatave, Prokurorive dhe Policisë e Kosovës. Në vazhden e kësaj duhet të bëhet përditësimi i mjeteve dhe metodave të punës, i burimeve njerëzore si dhe digjitalizimi i administratës institucionale.

Siguria publike është domosdoshmëri e garantimit të një vendi sundim të me rendit dhe të ligjit. Prandaj, nëpërmjet fuqizimit të Policisë së Kosovës, rritjes së buxhetit, kapaciteteve njerëzore dhe investimeve kapitale, do të përmirësohet rrënjësisht siguria në rrugë, siguria për bizneset, do ta luftojmë dukurinë e plaçkitjeve dhe do ta rrisim sigurinë në shkollë. Në raundet e ardhshme të rekrutimit në kuadër të institucioneve të sigurisë, do të vihen kriteret për të promovuar rekrutimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, në veçanti për komunitetet e nën përfaqësuar. Patrullimi rrugor e në këmbë i policisë - nëpër secilën lagje të vendit - do të jetë masë e parë në këtë drejtim.

13. MBROJTJA SOCIALE DHE INTEGRIMI NË PUNËSIM

13.1. Mbrojtja sociale

Shteti i mirëqenies së përgjithshme shoqërore dhe i solidaritetit ndërshoqëror, i ngritur mbi parimet e dialogut social në mes pjesëmarrësve kryesorë dhe mbi bazat e tregut të lirë, do të jetë parimi bazë i ndërtimit dhe i zbatimit të politikave sociale të Qeverisë. Përmes politikave sociale synohet të arrihet mbulueshmëri e plotë e qytetarëve me skemat sociale, ruajtje e standardit të jetesës së grupeve të caktuara të shoqërisë dhe sigurim të një sistemi social dhe pensional të qëndrueshëm financiarisht.

Masat kryesore në politikat e mbrojtjes sociale përfshijnë:

- Intensifikimi i dialogut social ndërmjet punëdhënësve, punëmarrësve dhe institucioneve qeveritare, si dhe një përfshirje sa më e gjerë e përfaqësuesve të grupeve të interesit në këtë dialog.
- Miratimi i Ligjit të ri mbi Këshillin Ekonomik Social, që rezulton me caktimin e pagës minimale bazuar në parametrat ekonomikë dhe socialë.

- Rimodelimi i përgjithshëm i sistemit pensional, duke filluar me krijimin e Fondit për Mbrojtje Sociale, i cili, ndër të tjera, do të kontribuonte në arritjen e këtyre qëllimeve: garantimin e pensionit kontributiv të moshës; garantimin e pensionit invalidor të punës bazuar në kontributet e paguara; garantimin e pensionit familjar, bazuar në kontributet e paguara; garantimi i pensionimit të parakohshëm për kategoritë e caktuara të të punësuarve; mbrojtjen prindërore; shtesat për fëmijë; mbrojtjen nga papunësia; mbrojtjen nga sëmundjet afatgjate etj.
- Pensioni minimal i moshës sipas kriterëve të caktuara, ku të gjithë personat nga 65-vjeç e sipër mbulohen bazuar në kriteret adekuate socio-ekonomike.
- Unifikimi i kriterëve për pensione për personat me aftësi të kufizuar, duke filluar nga trajtimi i njëjtë i të gjitha kategorive, si në vlerësimin e aftësisë, ashtu edhe në trajtimin dhe përfitimin e njëjtë financiar për të gjitha kategoritë, si dhe përfitimin e beneficioneve të tjera varësisht nga nevojat.
- Rishikimi i rregullativës ligjore lidhur me përvojën së punës për të gjithë ata që kanë kontribuar dhe për ata që janë larguar nga puna gjatë viteve 90-të të shek. XX.

Për të zbatuar këto masa, do të ndërmerret një reformë e plotë e skemave pensionale, që përfshin hartimin e Ligjit unik për Pensione, krijimin e Fondit për Sigurime Sociale, hartimin e Ligjit unik për Personat me Aftësi të Kufizuar etj. Po ashtu, do të ndërmerret një reformë e shërbimeve sociale dhe familjare, ku hyjnë hartimi i Ligjit për Skemat Sociale (asistencën sociale), hartimi i Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare, krijimi i Grandit Specifik për Shërbime Sociale dhe Familjare, skema e shtesave për fëmijë në kuadër të sistemit të sigurimeve sociale etj.

Do të ofrohet mbështetje për Programin e Banimit Social, për të ofruar banim me standarde adekuate për familjet në nevojë. Në veçanti do të mbështeten programet për banim të pjesëtarëve të disa prej komuniteteve jo shumicë që jetojnë në kushte të vështira.

13.2. Integrimi në punësim

Promovimi i punësimit, në veçanti të personave të papunë dhe të grupeve të marxhinalizuara, do të përkrahët me masa specifike. Këto masa do të zbatohen krahas politikave sociale për të rritur mirëqenien e grupeve të caktuar të shoqërisë, siç janë gratë, të rinjtë, të papunët dhe grupet e tjera të marxhinalizuara.

Masat kryesore përfshijnë:

- Politikat aktive për punësim, si nga shteti, ashtu edhe nga sektori privat, përfshirë masa të veçanta për punësimin e personave nga grupet më në nevojë dhe pjesëtarët e komuniteteve joshumicë që janë të nënpërfaqësuar sa i përket punësimit dhe në kushte të vështira jetese.
- Trajnim i vazhdueshëm në shkollat profesionale për profesione që kërkohen në tregun e punës.
- Subvencionimi i pagave që marrin të rinjtë apo gratë në ndërmarrje private.
- Subvencionimi i kontributeve tatimore dhe pensionale që paguhen për çdo të punësuar, duke rimbursuar kompanive private këto kontribute që paguajnë për punësimin e grupeve të caktuara.

- Promovimi i praktikës në punë në sektorin privat si formë e përgatitjes profesionale dhe praktike të praktikantëve.
- Mbështetje me grante për start-up biznese për ndërmarrësit e rinj.
- Modernizim i infrastrukturës së qendrave për aftësim profesional në mënyrë që të trajnuarit në këto qendra të marrin njohurit më të reja dhe të jenë të gatshëm për tregun e punës pas përfundimit të trajnimit.
- Ofrim të programeve të targetuara për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë që janë më në nevojë për punësim dhe të ardhura.

Në këtë drejtim, do të ndërmerret një reformë në marrëdhënien e punës dhe avancim të të drejtave të punëtorëve, ku përfshihen ndryshimet që duhet të ndodhin në legjisllacionin e punës, në pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror, inspektoratin e punës, masat për sigurinë në punë, masat për luftimin e punësimit informal dhe legalizimin e marrëdhënies së punës, rritjen e numrit të inspektorëve të punës, avancimi i dialogut social duke përgatitur ligjin e ri për Këshillin Ekonomik Social, rishikimi i pagës minimale, si dhe largimi i shkallëshmërisë së pagës minimale etj.

14. KULTURA, RINIA DHE SPORTI

14.1. Kultura

Kultura luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë, prandaj ajo do të bëhet pjesë e jetës ekonomike e sociale të vendit. Do të promovohet konservimi dhe ruajtja e trashëgimisë sonë kulturore për brezat e ardhshëm. Do të ndërmerren aktivitete për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën kulturore të vendit, përfshirjen e edukimit artistik në arsimin formal dhe joformal, si dhe nxitjen dhe promovimin e bashkëpunimit ndërkulturor.

Zhvillimi i kulturës do të marrë parasysh parimet kulturore evropiane që synojnë respektimin e diversitetit kulturor si dhe ruajtjen dhe kultivimin e trashëgimisë së përbashkët kulturore. Agjenda Evropiane për Kulturën i ka përcaktuar tre objektiva kryesorë: (i) të kuptuarit, respektimin dhe promovimin e diversitetit kulturor, (ii) nxitjen e dialogut ndërkulturor dhe trajtimin e kulturës si katalizator të kreativitetit, si dhe (iii) vlerësimin e rolit të kulturës si faktor i rëndësishëm i krijimit dhe i thellimit të raporteve ndërkombëtare.

Masat gjithëpërfshirëse në kulturë:

- Do të sigurohet funksionim profesional dhe apolitik i institucioneve të kulturës, si në nivel nacional ashtu dhe në nivel lokal. Kjo do të realizohet duke rritur pjesëmarrjen e qytetarëve, e sidomos të grupeve të ndryshme të artistëve, në vendimmarrje në institucione kulturore. Kjo qasje do të kthejë besimin në institucione kulturore dhe do të ndikojmë në ndryshimin e vetëdijes për kulturën.
- Do t'i kushtohet rëndësi përafërimit të legjislacion kulturor, si dhe strategjisë për zhvillimin e kulturës në Kosovë, me ato të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.
- Do të kultivohen relacioneve të veçanta me Shqipërinë dhe vendet e tjera në të cilat jetojnë shqiptarët. Forcimi i relacioneve me shtetet e tjera, nëpërmjet përfaqësimit diplomatik, do të shënojë shkallë të re të komunikimit kulturor të Kosovës, nëpërmjet vendosjes së atashëve kulturorë, si dhe qarkullimit të vlerave kulturore dhe të krijuesve.
- Do të ristrukturohet Skema e Funksionimit të Institucioneve Nacionale e Lokale dhe reformimin e administratës së tyre. Pikënisje do të jenë institucionet e trashëgimisë kulturore, si bartëse dhe shprehëse të identitetit kulturor e nacional.
- Do të rritet në mënyrë graduale buxheti për kulturën, duke e mundësuar shndërrimin e kulturë në aset të qëndrueshëm të zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe ekonomik të vendit.
- Do të përkrahen krijuesit e të gjitha fushave në aktivitetet e tyre të pavarura.
- Do të digjitalizohen materialet bibliotekare, arkivore dhe muzeore.
- Do të promovohet diplomacia kulturore në kuadër të diplomacisë publike të Republikës së Kosovës.
- Do të mbështeten aktivitetet kulturore të komuniteteve jo shumicë me qëllim të ruajtjes dhe promovimit të pasurisë kulturore të tyre si pasuri kulture e shtetit të Kosovës.
- Do të angazhohemi për kthimin e fondit të trashëgimisë kulturore që ndodhet në Serbi, si pjesë e dialogut për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë.
- Do të promovohet rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën kulturore që përkon me orientimet strategjike të BE-së për kulturën.

Mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore:

- Do të kompletohet dhe zbatohet korniza ligjore për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, duke përgatitur Ligjin e ri për Trashëgiminë Kulturore, si dhe Ligjin për Muzetë. Të dy këto ligje do të ofrojnë mundësi më të mira për menaxhimin e trashëgimisë kulturore. Gjithashtu, do të zbatohet Strategjia për Ruajtjen dhe Promovimin e Trashëgimisë Kulturore 2017-2027. Do të bëhet funksionalizimi i të gjitha institucioneve shtetërore që merren me Trashëgimi Kulturore.
- Do të krijohet fondi për hulumtim/studime në Trashëgiminë Kulturore dhe për zhvillim të kuadrit të ri të specializuar. Për këtë qëllim, Qeveria do të stimuloi komunitetet shkencore që merren me Trashëgimi Kulturore, përfshirë institucionet e larta arsimore në bashkëpunim me institucionet e Trashëgimisë.
- Do të punohet në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë fetare në Kosovës bazuar në Kushtetutë dhe ligjet në fuqi.

- Do të krijohet fondi kombëtar për konservim/restaurim të Trashëgimisë Kulturore, duke shtuar kështu kujdesin për monumentet historike, kulturore dhe fetare. Qeveria do të vazhdojë me implementimin e programit për intervenime emergjente, me rol kyç të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, si institucion bartës i proceseve të restaurimeve dhe konservimeve.
- Do të fuqizohet Regjistri Nacional i Trashëgimisë kulturore, ku përfshihen zonat me rëndësi të veçantë, Trashëgimia Kulturore në rrezik; Trashëgimia Kulturore nën Mbrojtje të Përhershme etj. Ky regjistër do të përditësohet duke krijuar bazë të të dhënave të trashëgimisë kulturore dhe digjitalizim i plotë i informatave për asetet e trashëgimisë kulturore.
- Do të riorganizohen institucionet publike të trashëgimisë kulturore në përputhje me nevojat e kohës, përfshirë edhe themelimin e institucioneve të reja që i mungojnë vlerave trashëgimore në Kosovë. Mbështetje e veçantë do t'i jepet Institutit Arkeologjik të Kosovës, si institucion kompetent për hulumtimin dhe studimin e Trashëgimisë Arkeologjike, në nivel kombëtar, i pavarur financiarisht dhe me liri akademike. Pastaj, do të rridefinohet roli i Institutit për Mbrojtje të Monumenteve të Kosovës, si institucion kompetent për konservim-restaurim të Trashëgimisë Kulturore të palëvizshme, i pavarur financiarisht (krijimi i kodit të veçantë buxhetor), si dhe përgjegjës për promovim të trashëgimisë kulturore. Për të gjitha këto institucione do të përgatitet statutet adekuate, ku definohej raportet e përgjegjësisë, menaxhimit financiar etj.
- Do të funksionalizohet Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore bazuar në ligj, si organ mbikëqyrës në fushën e trashëgimisë kulturore lidhur me restaurimet, respektimin e dokumentacionit adekuat, mbrojtjen e aseteve kulturore nga shkatërrimet, si dhe mbarëvajtjen ligjore të veprimtarive të institucioneve të Trashëgimisë Kulturore.
- Do të hartohen Planet e Menaxhimit për të gjitha asetet e trashëgimisë kulturore të rëndësishme të veçantë në një afat optimal.
- Do të krijohet rrjeti i parqeve arkeologjike, përfshirë lokalitetin arkeologjik "Ulpiana", në Dresnik të Klinës, Kështjella e Novobërdës dhe disa nga pikat më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike, duke i kthyer këto lokacione në pika të rëndësishme turistike për të promovuar trashëgiminë dhe kulturën tonë.
- Do të themelohet Muzeu Arkeologjik dhe Muzeu Etnologjik përmes miratimit të ligjit për muzetë. Por, në konsultime të gjera, do të shqyrtohet mundësia për themelimin e Muzeut të Paqes, nëpërmjet të cilit do të paraqitet rrugëtimi i popullit të Kosovës për liri dhe paqe. Në pajtim me rregullativën ligjore përkatëse, muzetë do të funksionojnë si një rrjet i muzeve me qasje të lirë për publikun me qëllim të promovimit të trashëgimisë kulturore muzeore të Kosovës brenda dhe jashtë vendit.

Edukimi artistik: Do të mbështeten projektet e veçanta për edukimin artistik në arsimin formal dhe joformal. Do të ndërmerren masa për përfshirjen e më shumë njerëzve me nevoja të veçanta në jetën kulturore. Do të hartohen politika të veçanta për përfshirjen e personave të moshës së tretë (pensionistëve) në aktivitetet artistike të institucioneve dhe operatorëve kulturorë. Në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe me atë të Punës dhe Mirëqenies Sociale, do të ofrohen programe për krijimin e mundësive për krijime artistike në qendrat e mbajtjeve dhe qendrat korrektuese, si dhe për ekspozimin, plasimin dhe shitjen e tyre. Kësisoj, do të ndikohet në mirëqenien emocionale të këtyre kategorive, si dhe do të rrisim shanset e tyre për pjesëmarrje në jetën sociale.

Modernizimi i infrastrukturës kulturore: Do të angazhohemi për renovimin e godinës së Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës duke instaluar sistemin e mbrojtjes në depot e lëndës arkivore; ndërtimi i Muzeut të Artit Bashkëkohor; ndërtimi i Muzeut të Historisë së Natyrës; ndërtimi i Muzeut Arkeologjik; renovimi i Bibliotekës Kombëtare “Pjetër Bogdani”; mbështetje financiare për renovimin e objekteve të artit dhe të kulturës nëpër komuna; ndërtimi i objekteve të qendrave rinore dhe kulturore nëpër komuna e të tjera.

Artet skenike: Në kuadër të mbështetjes së institucioneve kulturore të artit skenik, do të sigurohet buxhet adekuat për Qendrën Kinematografike e Kosovës, Teatrin Kombëtar të Kosovës, Teatrot e Qyteteve të Kosovës, Teatrot e pavarura dhe grupet teatrore, Baletin Kombëtar të Kosovës, Festalet kombëtare dhe ndërkombëtare, për promovime dhe prezantime ndërkombëtare, për digjitalizimin e arkivit, produktionit teatror dhe filmik, bursa të veçanta për sektorët e filmit dhe teatrit, mbështetje për grupet teatrore në edukimin parauniversitar, për rrjetëzimin e teatrove, për artin skenik në hapësirat publike, për botime të veçanta, konferenca, seminare e punëtori dhe për aktivitete të tjera. Për të gjitha këto institucione dhe aktivitete, do të krijohet edhe baza ligjore për sigurim të financimit shtesë dhe për menaxhim financiar të pavarur.

14.2. Rinia

Në fushën e rinisë, do të fuqizohen kapacitetet e organizatave rinore dhe mekanizmave përfaqësues të rinisë. Do të krijohet korniza adekuate rregullative, në mënyrë që të garantohet pjesëmarrja e të rinjve në nivele të ndryshme vendimmarrëse, si dhe do t'u kushtohet kujdes i veçantë grupeve të marginalizuara të të rinjve.

Rinia do të mbështetet duke ofruar arsimim cilësor në profile arsimore mbi bazat e nevojave të tregut të punës. Do të zhvillohet skema për mbështetje për punësim të të rinjve, subvencionimit të ndërmarrësve të rinj, lehtësira për tranzicion nga shkolla në punësim, mundësi për punë praktike duke bashkëpunuar ngushtë me ndërmarrjet, promovim i punës vullnetare, trajnim i vazhdueshëm për integrim në tregun e punës, ndihmë për banim për studentët, mbështetja e qendrave për inovacion të të rinjve etj.

Do të punohet në krijimin dhe zbatimin e masave lehtësuese për çështjen e banimit për familjet e reja, pastaj në njohjen e punës vullnetare si përvojë e punës si formë e tranzicionit nga shkollimi në punësim, rritja e mbështetjes financiare për organizatat rinore, mbështetje e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare rinore etj. Në të gjitha masat e mbështetjes për rini, fokus do të kenë edhe të rinjtë e komuniteteve jo shumicë për të mundësuar integrim më të madh të tyre në shoqërinë kosovare.

14.3. Sporti

Do të përgatitet Strategjia e re e Sportit, bazuar në Kartën Evropiane të Sportit, ku janë të parapara parimet e sportit për të gjithë, kodi i etikës në sport, konventa lidhur me parandalimin e dhunës në sport, konventa për parandalimin e dopingut në sport dhe deklarata për sportin të samitit të shefave të shteteve të Bashkimit Evropian në Amsterdam dhe Kartën Olimpikë.

Do të mbështetet zhvillimi i talenteve sportive dhe ndërkombëtarizimi i sportit. Do të mbështeten profesionistët sportivë për arritje të larta. Do të fuqizohet autonomia e federatave sportive dhe Komitetit Olimpik dhe Komitetit Paraolimpik të Kosovës. Do të promovohet sporti për të gjithë. Do të punohet në funksionalizim dhe avancim të sportit shkollor, mbështetje për personat me nevoja të veçanta, si dhe integrim të komuniteteve jo shumicë në të gjitha aktivitetet sportive. Do të fuqizohet mjekësia sportive, duke fuqizuar agjencinë antidoping dhe sektorin për hulumtimet antropologjike dhe shkencore në sport. Do të krijohet databaza e licencimeve të sistemit sportiv në Kosovë.

Në veçanti do të punohet në avancimin e kornizës ligjore sportive në bashkëpunim me federatat sportive, në rregullimin e shpërblimeve për të arriturat e veçanta, rregulloren për bursa, rregulloren për shpalljen e sportistit të vitit. . Do të definohet çështja e pronësisë dhe menaxhimit të infrastrukturës sportive, pastaj fuqizimi i regullativës për parandalimin e dhunës në sport, çështja e sponsorizimeve në sport.

Do të bëhet modernizimi i infrastrukturës sportive, renovimi i palestrave ekzistuese dhe stadiumeve të futbollit, pishina olimpike dhe gjysmë-olimpike, palestrat e reja nëpër komuna, rehabilitimi i qendrave të skijimit, ndërtimi i shtigjeve të atletikës në qendrat e mëdha të Kosovës, ndërtimi i terreneve të tenisit nëpër komuna, ndërtimi i stadiumit nacional me standarde të UEFA/FIFA-s, ndërtimi i fushave ndihmëse të futbollit, ndërtimi i poligoneve sportive në shkolla dhe lagje. Investimet në infrastrukturën sportive do të promovohen edhe përmes partneritetit publiko-privat, në veçanti investimet e mëdha infrastrukturore sportive.

15. DIASPORA

Kosova renditet në grupin e vendeve me diasporë të madhe në botë e që është pasuri për vendin. Qeveria e Kosovës do të angazhohet në ruajtjen e identitetit etno-kulturor të diasporës, zhvillimin dhe ruajtjen e lidhjeve sociale, politike dhe ekonomike të diasporës me Kosovën, si dhe avancimin e pozitës së përgjithshme shoqërore të diasporës në vendet ku janë.

Do të punohet në drejtim të rritjes së përfaqësimit politik të diasporës në proceset vendimmarrëse në Kosovë, krijimin e mundësive më të mira për votim të diasporës sipas praktikave të vendeve evropiane, zhvillimin e komunikimit institucional në mes të diasporës dhe Kosovës nëpërmjet krijimit të Këshillit Konsultativ të Diasporës, në lehtësimin e udhëtimeve për diasporën, mbështetjen e investimeve nga diaspora, mbështetjen e organizimit në fushën e kulturës dhe arsimit.